

An aerial photograph of a city at sunset. In the foreground, a modern building with a complex, dark, geometric facade and numerous white, dome-shaped roofs is visible. Behind it, a large, white, classical-style church with a tall bell tower stands out. The city is densely packed with various buildings, and the sky is filled with soft, golden light from the setting sun, creating a warm and dramatic atmosphere.

Trusti

RAPORTI VJETOR

2024

Botues
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës

Botuar
Maj 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara®
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Kosovski Penzijski Štedni Fond
Kosovo Pension Savings Trust

TABELA E PËRMBAJTJES

0

Treguesit kryesorë
Misioni dhe ambicia
Parathënie



8-23

1

Qeverisja,
menaxhimi dhe
financat



25-43

4

Kontributet dhe
pensionimet



66-71

5

Demografia
e kontribuuesve



72-85

6

Legjislacioni



86-89

2

Aktivitetet



44-53

3

Investimi i kursimeve
pensionale



54-65

7

Raporti i auditorit të
pavarur dhe pasqyrat
financiare - Operacionet



ANEKS

8

Raporti i auditorit të
pavarur dhe pasqyrat
financiare - Mjetet
Pensionale



ANEKS

AKRONIMET

FKPK

Fondi i
Kursimeve
Pensionale i
Kosovës

ATK

Administrata
Tatimore e
Kosovës

BQK

Banka
Qendrore e
Republikës së
Kosovës

KUVENDI

Kuvendi i
Republikës së
Kosovës

ASK

Agjencia e
Statistikave e
Kosovës

PTF

Programi i Tërheqjes
në Faza (i kursimeve
pensionale nga
FKPK)

AKRONIMET

QEVERIA

Qeveria e
Republikës së
Kosovës

SNRF

Standardet
Ndërkombëtare të
Raportimit Financiar

ETF

Fonde të tregtuara në
bursë nga një broker, ku
përmbledhen një sërë
instrumentesh investuese
(aksione, bono, mallra ose
të përziera) që ndjekin një
indeks të caktuar.

MNM

Mjetet Neto nën
Menaxhim

DPI

Deklarata e
Parimeve të
Investimeve

SAM

Strategjia e
Alokimit të
Mjeteve

N M M E T

Përmbledhje e Treguesve Kryesorë

PERFORMANCA E INVESTIMEVE PËR 10 VJETËT E FUNDIT (KUMULATIVE)

PERIUDHA

	1 - vjeçare	2 - vjeçare	3 - vjeçare	4 - vjeçare
Kthimi bruto nga investimet (në milionë)	€247.2	€334.9	€214.9	€442.2

INVESTIMET	2024	2023
• PORTOFOLI STANDARD		
Çmimi i aksionit në fund të vitit	€1.8233	€1.6764
Ndryshimi i çmimit të aksionit gjatë vitit	+8.76%	+3.05%
Kthimi bruto nga investimet për vitin	€224,022,743	€81,106,745
Kthimet e tjera për vitin*	€3,205,966	€2,000,000
• PORTOFOLI I BALANCUAR		
Çmimi i aksionit në fund të vitit	€1.0405	--
Ndryshimi i çmimit të aksionit gjatë vitit	4.05%	--
Kthimi bruto nga investimet për vitin	€14,384,339	--
Kthimet e tjera për vitin*	€124,103	--
• PORTOFOLI KONSERVATIV		
Çmimi i aksionit në fund të vitit	€2.2065	€2.1302
Ndryshimi i çmimit të aksionit gjatë vitit	+3.58%	+3.47%
Kthimi bruto nga investimet për vitin	€5,283,189	€4,556,800
Kthimet e tjera për vitin*	€169,931	--
• MNM (TË NJËSUARA)		
Portofoli Standard	€2,652,013,991	€2,570,540,693
Portofoli i Balancuar	€376,412,634	--
Portofoli Konservativ	€153,414,695	€131,267,932
• KONTRIBUTET DHE KONTRIBUESIT		
Kontributet e arkëtuara për vitin	€315,807,132	€286,181,346
Kontributet e arkëtuara prej themelimit	€3,032,703,466	€2,716,896,334
Llogari të reja të hapura gjatë vitit	39,231	41,968
Numri i llogarimbajtësve në fund të vitit	874,194	834,963
Numri i kontribuuesve aktivë në fund të vitit	452,366	442,383

5 - vjeçare	6 - vjeçare	7 - vjeçare	8 - vjeçare	9 - vjeçare	10 - vjeçare
€514.1	€674.8	€590.0	€692.6	€757.2	€786.1

PENSIONIMI	2024	2023
Llogari me tërheqje kursimesh për vitin*	7,905	7,684
Mjetet e tërhequra për vitin	€69,748,791	€71,606,416
Llogari me tërheqje të plotë nga themelimi**	80,901	73,973
Mjetet e tërhequra prej themelimit***	€700,156,087	€630,407,296

• TARIFAT DHE SHPENZIMET

Tarifa investuese	0.310%	0.320%
Tarifa operacionale	0.048%	0.050%
Tarifat vjetore në vlerë nominale	€10,567,254	€9,421,417
Shpenzimet investuese për vitin	€5,660,155	€5,846,523
Shpenzimet operacionale për vitin	€1,233,417	€1,054,703

• ALOKIMI I MJETEVE DHE eTRUSTI

Kontributet e paalokuara në fund të vitit	€2,395,695	€3,192,323
Kontributet e paalokuara ndaj gjithsej kontributeve	0.079%	0.117%
Numri i llogarive në eTrusti	339,410	316,140

* Në këtë numër përfshihen pensionimet vjetore të moshës, rasteve të vdekjes, invaliditetit dhe shtetasve të huaj.

** Në këtë vlerë përfshihen pensionimet e moshës, rasteve të vdekjes dhe shtetasve të huaj, por nuk përfshihen rastet e invaliditetit.

***Në këtë shifër përfshihet edhe vlera e tërhequr për 10%-shin (dhjetor 2020 deri prill 2021).

Shpërndarja e Investimeve

MË 31.12.2024

Mjetet pensionale investohen përmes fondeve të hapura që drejtohen nga menaxherët e këtyre fondeve në aksione, instrumente borxhi, para të gatshme dhe në instrumente të tjera financiare të korporatave botërore dhe të shteteve sovraane. Në fund të vitit 2024 FKPK-ja kishte investime direkte dhe indirekte në instrumente financiare të 3,312 emetuesve botërorë (2023: 1,993).


10 SHTETET ME PLASMANET MË TË LARTA NDAJ GJITHSEJ MJETEVE

NËN MENAXHIM TË FKPK-SË

• NR.	PLASMANI	PËRQINDJA	MJETET E FKPK-SË
1.	SHBA	46.53%	€1,481,181,249
2.	Kosovë	18.89%	€601,351,769
3.	Francë	7.44%	€236,743,016
4.	Britani e Madhe	4.10%	€130,540,184
5.	Japoni	3.26%	€103,894,862
6.	Itali	2.97%	€94,453,434
7.	Gjermani	2.06%	€65,643,763
8.	Holandë	1.40%	€44,614,299
9.	Kanadë	1.31%	€41,565,471
10.	Zvicër	1.24%	€39,316,198
GJITHSEJ TOP DHJETËSHA		89.20%	€2,839,304,245

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE GLOBALE E GJITHSEJ MJETEVE TË FKPK-SË

SHËNIM: FKPK-ja nuk mund të garantojë se performanca e investimeve në të ardhmen do të jetë sikurse në të kaluarën. FKPK-ja i investon mjetet e saj nën menaxhim me qëllim që: së pari, të ruajë fuqinë blerëse të kursimeve pensionale dhe, së dyti, për t'ia rritur atyre edhe më shumë vlerën. Sidoqoftë, të gjitha investimet i nënshtrohen një niveli të riskut varësisht prej shkallës së kthimit të synuar. Kjo njësoj vlen edhe për investimet e FKPK-së, të cilat i nënshtrohen një sërë risqesh, por pa u kufizuar vetëm në to, sikurse janë: risku valutor, risku i normës së interesit, risku kreditor, risku i çmimit, risku politik, risku i palës tjetër, risku i likuiditetit, e të tjerë. Më shumë detaje për secilin risk dhe ndërlidhjen e tij sipas secilit fond investues prezantohen në pasqyrat financiare, të bashkëngjitura me këtë raport.




PLASMANET KRYESORE NË NJË ENTITET TË VETËM NDAJ MJETEVE

NËN MENAXHIM TË FKPK-SË



• NR.	PLASMANI	MJETET E FKPK-SË (në milionë)	PËRQINDJA
1.	Thesari i Kosovës	€437.1	13.7%
2.	Microsoft	€66.7	2.1%
3.	Apple	€57.9	1.8%
4.	Thesari i Italisë	€56.7	1.8%
5.	Alphabet	€56.5	1.8%
6.	NLB Bank Kosovë	€52.6	1.7%
7.	Nvidia	€50.1	1.6%
8.	PCB Bank Kosovë	€35.2	1.1%
9.	Thesari i Austrisë	€31.8	1.0%
10.	Amazon	€30.8	1.0%
GJITHSEJ TOP DHJETËSHA		€875.4	27.6 %

SHPËRNDARJA SIPAS INSTRUMENTEVE FINANCIARE TË TRE PORTOFOLAVE



Portofoli Standard



Portofoli i Balancuar



Portofoli Konservativ



INVESTIMET

2024

2023

2022

Më 1 prill 2024 u lansua portofoli i tretë investues (Portofoli Balancuar), i dedikuar për kontribuuesit e moshës 58 deri 62 vjeçare. Në Portofolin Standard u ngrit ekspozimi ndaj instrumenteve me risk më të lartë.

Kthimi neto për vitin ishte +8.8% për Portofolin Standard, +4.1 për Portofolin e Balancuar dhe +3.6% për Portofolin Konservativ. MNM u ngritën për 17.8%.

Filluan përgatitjet për portofolin e tretë investues (të Ndërmjetëm) dhe Deklaratën e Parimeve Investuese. Në Portofolin Standard vazhdoi reduktimi i ekspozimit ndaj instrumenteve me risk të lartë.

Kthimi neto për vitin ishte +3.1% për Portofolin Standard dhe +3.5% për Portofolin Konservativ. Mjetet neto nën menaxhim u ngritën për 12.1%.

Krijohet portofol i ri investues (Konservativ) që kontribuuesit afër pensionimit të mbrohen nga luhatjet e shpejta. U reduktua në nivelin më të ulët ekspozimi ndaj instrumenteve me luhatshmëri të lartë.

Kthimi neto për vitin ishte -5.5% për Portofolin Standard dhe +2.9% për Portofolin Konservativ. Mjetet neto nën menaxhim u ngritën për 2.5%.

Përkufizime Termash

AKSIONE

Instrument financiar që siguron pronësi në kompani, varësisht nga shkalla e investimit.

PORTOFOL

Është përdorim i disa instrumenteve financiare si aksione, bono, para e gatshme, ETF dhe të tjera në një investim të përbashkët; rezultatet investuese të të cilave përlogaritën së bashku dhe prezantojnë atë portofol.

LETRAT ME VLERË OSE OBLIGACIONET

Instrument financiar i emetuar nga një qeveri ose korporatë, që ka një afat të caktuar të maturimit dhe që zakonisht paguan, në afate të caktuara, një shumë të bazuar në kamata fikse ose fleksibile.

MULTI ASETË

Fonde investuese që kanë në përbërje një përzierje të instrumenteve në klasat e asetëve kryesore financiare (aksione, bono dhe para e gatshme).

RREZIK INVESTUES

Nënkupton gjasat ose mundësitë që të pësohen humbje nga investimi i ndërmarrë kundrejt një niveli të caktuar të fitimit.

BENÇMARK

Një nivel standard referues për ta krahasuar dhe analizuar performancën e investimeve. FKPK-ja e ka si bençmark për Portofolin Standard indeksin e çmimeve të konsumit të Kosovë, që ndryshe njihet si niveli i inflacionit në vend.

KONTRIBUT I DEFINUAR

Është një plan i përcaktuar i kontribuimit, ku kontributet fikse paguhën në një llogari individuale nga punëdhënësi dhe punëmarrësi. Më pas ato kontribute investohen dhe kthimet nga investimet (pozitive ose negative) i kreditohen llogarisë individuale. Në momentin e pensionimit kjo llogari përdoret për të ofruar përfitimin pensional, zakonisht përmes blerjes së anuitetit, i cili më pas mundëson të ardhura të rregullta mujore (variant ky që ende nuk ofrohet në Kosovë).

PORTOFOLI STANDARD

Është portofol i investimeve në FKPK i dedikuar për kontribuuesit e moshës prej 18 deri 57 vjeçare, mjetet pensionale të të cilëve investohen në instrumente të ndryshme financiare si depozitat bankare, obligacionet e Thesarit të Kosovës dhe kryesisht në fondet e hapura (mutual) dhe me risk investues të moderuar.

PORTOFOLI BALANCUAR

Është portofol i investimeve për pjesëmarrësit e moshave 58-62 vjeçare. Portofol me tolerancë më të ulët të riskut sesa Portofoli Standard për risk, e cila në afat të mesëm synon të gjenerojë kthim të lartë nga investimet duke investuar në një spektër të gjerë instrumentesh siç janë aksionet, obligacionet, multi-asetet dhe asetet reale.

OPERACIONET

2022

2023

2024

Vënia në punë e Portofolit Konservativ u bë pa asnjë vështirësi në softuerin për menaxhimin e llogarive. U shtua Kodi Digjital në pasqyra, ashtu që të mund të vërtetohet autenticiteti i tyre nga palët e treta. Po ashtu u mundësua shkarkimi pasqyrave edhe nga portali eKosova.

Kontributet e paalokuara u ngritën në 0.12% e kontributeve të arkëtuara.

Mirëmbajtja dhe avancimi i softuerit për menaxhimin e llogarive vazhdoi pa asnjë vështirësi. U bën përditësime në mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave digjitale të FKPK-së. Shërbimet digjitale në distancë vazhduan shtrirjen në përdorim.

Kontributet e paalokuara ishin afërsisht në 0.12% të kontributeve të arkëtuara.

U implementuan pa vështirësi dhe në kohë ndryshimet në portofolat investues. U vazhduan përditësimet në sigurinë e TI-së dhe uebfaqes së FKPK-së. U lansua aplikimi online për tërheqje të kursimeve pensionale.

Kontributet e paalokuara ishin afërsisht në 0.08% të kontributeve të arkëtuara.

PORTOFOLI KONSERVATIV

Është portofoli i investimeve në FKPK i dedikuar për kontribuuesit e moshës 63+ vjeçare, mjetet pensionale të të cilëve investohen në instrumente financiare të cilat janë të limituara në obligacionet e Thesarit të Kosovës dhe para të gatshme dhe me risk investues minimal.

AKSIONET PASIVE

Fondet e përbashkëta dhe të tregtueshme në bursa, ku përzgjedhja e aksioneve rrjedh nga një indeks i investueshëm (p.sh. MSCI World) dhe/ose nëngrupe brenda një universi të letrave me vlerë (p.sh. vlera e kapitalit, kategorizimi vlerë, dividendë); në vend të përzgjedhjes aktive dhe/ose qëndrimeve.

AKSIONET AKTIVE

Fondet e përbashkëta dhe në masë më të ulët fonde të tregtueshme në bursa, të cilat bëjnë një përzgjedhje aktive nga një univers i paracaktuar aksionesh dhe/ose kanë qasje aktive ndaj menaxhimit të riskut dhe/ose cazeve të riskut.

ASETET REALE

Investimet afatgjata në burimet natyrore (p.sh. tokë bujqësore, pyje, minerale dhe të drejtat minerare).

OBLIGACIONE TË THESARIT TË KOSOVËS

Instrumentet e borxhit të emetuara nga Thesari i Republikës së Kosovës, zakonisht të mbajtura deri në maturim.

DEPOZITA ME AFAT

Depozita me afat dhe marrëveshje të riblerjes me institucionet bankare vendore dhe ndërkombëtare, zakonisht të mbajtura deri në maturim.

TREGJET E PARASË

Fonde me likuiditet të lartë që përbëhen nga instrumente afatshkurtër që ofrojnë kthim të përafërt me Euribor; përdoret më shumë në kohë pasigurie dhe/ose perspektivë pesimiste për aksionet, e që zakonisht japin kthim më të lartë sesa llogaritë bankare.

PARAJA E GATSHME

Bilancet e parasë së gatshme në llogaritë bankare me BQK-në dhe brokerët. Bilanci i parasë së gatshme mbahet në minimum me likuiditet të mjaftueshëm për t'i paguar tërheqjet e kursimeve.

Shifra për pesë vjet


Për të gjitha mjetet nën menaxhim

34.8% NGRITJA
NETO E
MJETEVE

€514.1^{mln} KTHIMI
BRUTO NGA
INVESTIMET


kthimi nga
investimet

NGRITJA / RËNIA VJETORE E ÇMIMIT TË NJËSISË DHE KTHIMI BRUTO



kontributet
kumulative të
paalokuara

PËRQINDJA E KONTRIBUTEVE TË PAALOKUARA KUNDREJT TOTALIT
TË KONTRIBUTEVE DHE VLERA



NUMRI I LLOGARIMBAJTËSVE DHE KONTRIBUESIT SIPAS GJINISË

VITI	LLOGARI GJITHSEJ	BURRA	%	GRA	%	LLOGARI AKTIVE*	BURRA	%	GRA	%
	(A)	(B)	(B)/(A)	(C)	(C)/(A)	(D)	(E)	(E)/(D)	(F)	(F)/(D)
2020	707,388	469,286	66.3%	238,102	33.7%	387,526	249,355	64.3%	138,171	35.7%
2021	752,586	483,352	64.2%	269,234	35.8%	419,657	254,808	60.7%	164,849	39.3%
2022	792,995	507,028	63.9%	285,967	36.1%	428,891	262,339	61.2%	166,552	38.8%
2023	834,963	528,532	63.3%	306,431	36.7%	442,383	265,628	60.0%	176,755	40.0%
2024	874,194	553,906	63.4%	320,288	36.6%	452,366	270,191	59.7%	182,175	40.3%

* Llogaritë aktive paraqesin numrin e kontribuuesve për të cilët është bërë së paku një pagesë e kontributeve pensionale përgjatë periudhës së vitit përkatës.

20

Llogari gjithsej:

874,194

gra

36.6%



63.4%

burra

burra

553,906

gra

320,288



DHE KONTRIBUESIT AKTIVË

24

Llogari aktive:
452,366

gra
40.3%



59.7%
burra

burra
270,191
gra
182,175



misioni dhe ambicia

Misioni ynë është t'i investojmë kursimet pensionale dhe t'i administrojmë llogaritë individuale të kontribuuesve deri në pensionimin e tyre.

Ne angazhohemi që misionin tonë ta arrijmë përmes investimeve të matura të mjeteve me procese të efektshme administrative.

Ambicia jonë është që t'i ofrojmë shërbimet më të mira të mundshme për kontribuuesit si dhe të jemi institucioni më i besuar në Kosovë.

Ambicien tonë përpiqemi ta arrijmë përmes profesionalizmit, integritetit të stafit dhe transparencës institucionale.



Parathënie e Kryesuesit të Bordit dhe Drejtorit Menaxhues

E nderuara lexuese / I nderuari lexues,

raporti vjetor është publikimi më i rëndësishëm i FKPK-së, ku, së bashku me pasqyrat e audituara financiare, shpalosen çështjet më kryesore të detajuara vjetore të investimeve dhe të operacioneve.

Fokusi kryesor i çdo raporti vjetor i FKPK-së natyrshëm se është performanca e investimeve. Na vije mirë të njoftojmë që edhe viti 2024 u përmbyll me rezultat pozitiv e të kënaqshëm nga investimet, ku të tre portofolat e ngritën vlerën e mjeteve pensionale, përkatësisht me +8.76 Portofoli Standard, me +4.05% Portofoli i Balancuar dhe me +3.58% Portofoli Konservativ. Në vlerë nominale, kthimi i përbashkët vjetor bruto kapi shifrën e 247 milionë eurove.



€247 milionë.

➤ Vlerësuar në afatgjatë, FKPK-ja me këtë vit i numëroi 20 vjet të kthimeve pozitive nga investimet dhe vetëm tri me kthime negative. Në këto 23 vjet aktivitet, janë akumuluar gjithsej 997 milionë euro kthim bruto nga investimet.

Sa i përket mjeteve nën menaxhim, ato u ngritën sivjet me shumë rekorder prej 483 milionë euro për të arritur në 3.2 miliardë euro. Ngritja erdhi nga 319 milionë euro kontribute të reja dhe 247 milionë euro nga investimet, duke i zbritur rreth 70 milionë euro për pagesa të pensione, 10 milionë euro për tarifa dhe 3 milionë euro për refondime.

Përkundër treguesve mjaft të kënaqshëm nga investimet edhe këtë vit, besojmë se vendimi më i rëndësishëm për FKPK-në ishte miratimi i Deklaratës së Parimeve të Investimeve, në fuqi prej prillit 2024. Mbi këtë deklaratë Bordi Drejtues vendosi për shtimin e portofolit të tretë investues (Portofolit të Balancuar për kontribuuesit e moshës 58 deri 62 vjeçare), duke besuar se është zgjidhja më e mirë e mundshme si për sfidat afatshkurtra, të luhatjeve të shpejta e të forta në investime, ashtu edhe për përfitimet afatgjata, nga potenciali i rritjes nga investimet në aksione. Rrjedhimisht Portofoli i Balancuar do të shërbejë si fazë tranzicioni prej Portofolit Standard drejt atij Konservativ.

Përveç kësaj, Deklarata e Parimeve të Investimeve ka përcaktuar dhe rregulluar çështje rreth vendimmarrjes së investimeve, parimeve dhe bindjeve investuese, alokimit strategjik dhe kufijve të rinj sipas klasifikimit të instrumenteve investuese por edhe objektiva të matshëm për të tre portofolat, sipas kufijve minimal e maksimal. E që të gjitha këto ndryshime e përditësime janë bërë në përputhje me udhëzimet përkatëse legjislative dhe praktikat më të mira.

Performanca e investimeve të këtij viti gjykojmë se ishte rezultat i ngritjes së fuqishme të tregut global të aksioneve, që u stimulua nga rënia e lehtë e inflacionit, përmirësimi i ngritjes ekonomike, ulja e normave të interesit dhe ngritjes së të ardhurave të korporatave. Megjithatë, në periudha të caktuara kishim luhatje të forta e të shpejta të tregjeve financiare, duke e vendosur FKPK-në para ndërmarrjes së vendimeve taktike mbrojtëse.

Nën anën tjetër, procesit të ndryshimeve dhe përmirësimeve në fushën e investimeve i parapriu edhe ngritja e kapaciteteve të brendshme profesionale, duke rekrutuar staf shtesë në njësinë e investimeve dhe riskut. Tani kjo njësi ka potencial për të prodhuar analiza dhe raporte që ia lehtësojnë procesin vendimmarrës Komisionit të Investimeve dhe Bordit Drejtues.

Njëkohësisht, u arrit që pa vështirësi të implementohet në sistem portofoli tretë investues. Ndryshimet në portofolat investues u përcollën me informimin paraprak të të gjithë kontribuuesve përkatës për kalimin në portofolin e caktuar sipas moshës së tyre.

Në pjesën tjetër të veprimit ditor të FKPK-së, operacionet në zyrë dhe në distancë, vazhduan të kryhen pa pengesa. Stafi i institucionit e vazhdoi përmirësimin e proceseve të brendshme digjitale, si në mirëmbajtje e rritje të sigurisë ashtu edhe të funksionaliteteve operacionale. Nga digjitalizimi i proceseve në FKPK, po arrihet që qindra mijëra shërbime të ofrohen në distancë, përmes internetit. Këtë vit i kishim rreth 520 mijë vetëshërbime në eTrusti dhe rreth 350 mijë vetëshërbime në eKosova.

Të gjitha vendimet dhe treguesit financiarë të FKPK-së i janë nënshtruar edhe këtë vit auditimit të jashtëm dhe të brendshëm. Nga ky proces nuk kanë rezultuar gjetje serioze, duke e konfirmuar se FKPK-ja po operon në harmoni me standardet më të larta të raportimit financiar dhe sipas praktikave të qeverisjes korporative.

Përkundër arritjeve e përmirësimeve të këtij viti, jemi të përkushtuar që FKPK-ja të vazhdojë, jo vetëm ta ruajë hapin me ambientin shumë dinamik të investimeve ndërkombëtare dhe përparimeve në teknologjinë e informacionit, por edhe t'i përditësojë e përmirësojë të gjitha fushat e operimit të saj.

Për fund, duam t'i shprehim falënderimin tonë Kuvendit të Kosovës, Bankës Qendrore të Kosovës, Administratës Tatimore të Kosovës, Agjencisë së Regjistrimit Civil, por edhe institucioneve të tjera, për përkrahje dhe bashkëpunim përgjatë vitit 2024!


Besojmë, dhe e shprehim vullnetin tonë të plotë, që kjo do të vazhdojë edhe viteve në vijim.

Singerisht,
Emanuel Bajra
Kryesues i Bordit Drejtues

Adrian Zalli
Drejtor Menaxhues

• **Portofoli
Standard**
(për kontribuuesit e
moshës 15 - 57 vjeçare)

• **Portofoli i
Balancuar**
(për kontribuuesit e
moshës 58- 62 vjeçare)



• Portofoli Konservativ

(për kontribuuesit e moshës 63 vjeçare e sipër)

01

QEVERISJA, MENAXHIMI DHE FINANCAT

Organizata, Bordi Drejtues dhe Organogrami
Anëtarët e Bordit Drejtues në fund të vitit
Procesi i vendimmarrjes së Bordit Drejtues
Komisionet e Bordit Drejtues
Menaxhmenti dhe Administrata
Mbikëqyrja dhe auditimi
Financimi
Shpenzimet

Organizata

FKPK-ja është themeluar si institucioni i vetëm për menaxhimin dhe investimin e kontributeve të detyrueshme pensionale të të punësuarve, të punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve në Kosovë, si dhe për administrimin e llogarive individuale të kursimeve pensionale deri në pensionim. FKPK-ja u themelua me Ligj në dhjetor të vitit 2001, si institucion jo për profit. Si i tillë, qëllimi i FKPK-së është t'i shërbejë vetëm interesit më të mirë të kontribuuesve të saj.

Në gusht 2002 FKPK-ja u funksionalizua në tërësi me Bord Drejtues, Administratë dhe vendosje të proceseve. Asokohe Administrata numëronte 22 punonjës dhe kishte pesë njësi. Gushti i vitit 2002 ishte po ashtu muaji në të cilin u arkëtuan kontributet e para nga punonjësit e sektorit publik.

Më 2003, të vetëpunësuarit dhe të punësuarit e sektorit privat iu bashkëngjiten kursimit pensional. Ndërsa për herë të parë mjetet pensionale u investuan më 2003 në fonde të parasë së gatshme. Investimet pasuan në aksione më 2004 dhe me investime në fonde që tregtonin me instrumente borxhi më 2006.

Më tutje investimet u zgjeruan duke shtuar fondet multiasetëshe (më 2010) e fondet me target riskun (më 2011). Më 2014 e 2015 në portofolin investues u shtuan fondet investuese multi-asetëshe me menaxhim risku, ato të aksioneve me dividend si dhe me menaxhim risku. Më 2018 u përmbyll procesi i përzgjedhjes së brokerit për investime në fondet ETF, që i dha institucionit më shumë alternativa investuese. Më 2021 kishim rekord fondesh investuese dhe instrumente të përfshira ndonjëherë. Më 2022, si pjesë e masave mbrojtëse, u ulen ndjeshëm investimet në instrumente me risk të lartë. Më 1 prill 2024 u lansua portofoli i tretë investues (Portofoli i Balancuar), i dedikuar për kontribuuesit e moshës 58 deri 62 vjeçare.

Në Kosovë investimi i parë ndodhi në depozitat bankare më 2008, ndërsa investimi i parë në fletobligacione afatshkurtra të Kosovës u realizua më 2012. Më 2014 e 2015 u fillua me investimet në fletobligacionet afatmesme dhe afatgjata. Më 2020 arritën në nivele rekorde investimet në letrat me vlerë të Qeverisë. Më 2024 kishim shtim të investimeve në depozitat bankare në Kosovë, ndërsa investimet në fletobligacione kishin një ulje të lehtë.

Bordi Drejtues

FKPK-ja qeveriset nga Bordi Drejtues, anëtarët e të cilit përzgjidhen me konkurs publik, shqyrtohen nga Komisioni Përzgjedhës, propozohen nga Qeveria e Kosovës dhe emërohen me mandat katër-vjeçar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-101 i Republikës së Kosovës për Fondet Pensionale në Kosovë, bashkë me plotësimet dhe ndryshimet e tij (me Ligjin Nr. 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/ L116), e shtjellon detajisht funksionimin dhe përgjegjësitë e FKPK-së dhe Bordit Drejtues.

Rregullat pensionale të BQK-së nxjerrin legjislacionin dytësor në lidhje me investimin e mjeteve pensionale, matjen e performancës, tërheqjen e kursimeve pensionale dhe kërkesat për raportim të FKPK-së. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit Drejtues përfshijnë, por nuk kufizohen në: përzgjedhjen ose largimin e menaxhuesve të mjeteve, kujdestarëve, fondeve të hapura për investime si dhe palëve të treta; miratimin e parimeve dhe politikave për investimin e mjeteve pensionale; punësimin e personelit ekzekutiv dhe miratimin e pasqyrave të FKPK-së.


Bordi Drejtues mund të ketë shtatë anëtarë me drejtë vote, dhe një anëtar pa të drejtë vote, që e përfaqëson Qeverinë e Kosovës. Por as gjatë vitit 2024 në Bordin Drejtues nuk është emëruar anëtari përfaqësues i Qeverisë, pa të drejtë vote.

Së paku pesë nga anëtarët me të drejtë vote duhet të jenë me së paku dhjetë vjet përvojë në fushën e investimeve ose të menaxhimit të fondeve pensionale; së paku një anëtar me përvojë relevante për të përfaqësuar interesat e punëmarrësve në Kosovë, dhe së paku një anëtar me përvojë relevante për të përfaqësuar interesat e punëdhënësve në Kosovë.

Në fund të dhjetorit 2024 numri i anëtarëve në Bordin Drejtues ishte i plotë. Dy pozitat që ishin vakante në fundvitit 2023 (përfaqësuesi i punëmarrësve dhe ai i punëdhënësve) u emëruan më 5 dhjetor 2024.

STRUKTURA HIERARKIKE

Në fuqi prej 18 qershorit 2024





Z. Emanuel Bajra

Kryesues i Bordit Drejtues, Kryesues i Komisionit për Buxhet si dhe anëtar i Komisionit për Investime dhe Komisionit për Ankesa.

Financier dhe njohës i sistemit financiar dhe investues bankar, me përvojë mbi 20 vjeçare në sektorin publik dhe privat.

Ka pasur role të ndryshme në afarizmin bankar komercial në Lloyds Banking Group, HBOS, LBCM dhe TSB si edhe në tregjet private – jopublike. Ka përvojë ligjërimi në universitetet e Kosovës dhe jashtë.

➤ zgjedhur: korrik 2023

➤ mandati aktual i parë



Znj. Mimoza Mustafa

Kryesuese e Komisionit të Auditimit dhe anëtare e komisioneve për Investime dhe për Buxhet.

Ligjëruese në RIT Kosova (A.U.K), me mbi 20 vjet përvojë mësimdhënie në fushën e matematikës dhe statistikës.

Është e specializuar në fushën e Financës Kuantitative (MSc) dhe Matematikës së Aplikuar.

Karriera e saj në sektorin financiar ndërlidhet me pozita të rëndësishme në institucione financiare (vendore e ndërkombëtare), përfshirë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

➤ zgjedhur: korrik 2023

➤ mandati aktual i parë



Dr. Cyril Demaria

Kryesues i Komisionit të Investimeve dhe anëtar i Komisionit të Auditimit.

Ekspert ndërkombëtar i tregjeve private, me doktoraturë nga Universiteti i St Gallenit. Profesor i Afiliuar dhe ekspert i angazhuar në Europë.

Është partner dhe udhëheqës në Wellershoff & Partners; udhëheqës në Zyrën e Investimeve të UBS dhe drejtor kryesor i investimeve në Tiaré Investment Management.

➤ zgjedhur: korrik 2023

➤ mandati aktual i parë



Z. Trim Shala

Kryesues i Komisionit të Ankesave, anëtar i Komisionit të Investimeve dhe atij për Auditim.

Menaxher me përvojë mbi njëzet vjeçare në shërbimin për klientë dhe menaxhimin e operacioneve dhe me një kombinim të pasur dhe të kristalizuar të njohurive dhe përvojës së drejtpërdrejtë përgjatë gjithë ciklit evolues të FKPK-së. Është i graduar me master (MBA) në administrim biznesi, në Universitetin e Sheffieldit në Selanik.

➤ zgjedhur: korrik 2023

➤ mandati aktual i parë



Dr. Shpresim Vranovci

Anëtar i Komisionit të Investimeve, i Komisionit për Buxhet dhe atij për Ankesa.

Profesionist i njohur dhe i respektuar në fushën e bankave dhe financave, me karrierë të pasur mbi 20 vjeçare. Ka shërbyer në role kyçe në disa institucione të njohura dhe të suksesshme në sektorin financiar në Kosovë. Ka përvojë të gjatë, mbi 10-vjeçare, në arsimin e lartë universitar, si ligjërues i menaxhmentit financiar dhe investimeve.

➤ zgjedhur: korrik 2023

➤ mandati aktual i parë




Z. Arsim Bruçaj

Në datën e raportimit nuk ishte emëruar ende anëtar në ndonjë komision *)

Me 22 vjet përvojë në banka, financa dhe konsulencë, duke ndërtuar një karrierë të suksesshme në pozita drejtuese e menaxheriale. Ai ka njohuri të thelluara mbi tregjet financiare, investimet dhe menaxhimin e rrezikut. Është i graduar MSc në Staffordshire University dhe ka ndjekur studimet në UCLA.

➤ zgjedhur: dhjetor 2024

➤ mandati aktual i parë



Z. Ali Vitija

Në datën e raportimit nuk ishte emëruar ende anëtar në ndonjë komision *)

Me 17 vjet përvojë aktive si përfaqësues sindikal, ka kontribuar në hartimin e ligjeve dhe udhëzimeve të shumta administrative, si dhe zhvillimin e politikave dhe strategjive për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Ka një bagazh trajnimesh në menaxhim dhe zhvillim ekonomik. Është i graduar me Master në Menaxhment dhe i diplomuar në Ekonomi.

➤ zgjedhur: dhjetor 2024

➤ mandati aktual i parë

* Anëtar i është emëruar nga Kuvendi i Kosovës në Bordin Drejtues më 5 dhjetor 2025. Për datën e raportimit (31 dhjetor 2024) ende nuk ishte emëruar në ndonjë komision. Ndarja e re e komisioneve, me përbërjen e plotë të Bordit Drejtues, ka filluar nga 16 janari 2025.

Vendimmarrja e Bordit Drejtues për Investimet

➤ TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

FKPK-ja qeveriset nga Bordi Drejtues. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues është për administrimin në mirëbesim të mjeteve pensionale.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në: adoptimin e parimeve dhe politikave për investimin e mjeteve pensionale; definimin e alokimit strategjik të mjeteve për fondet e FKPK-së si dhe përcaktimin e natyrës dhe shumave të çfarëdo ndryshimi në alokim, strategji dhe politikën investuese; përzgjedhjen, monitorimin dhe largimin e instrumenteve të hapura dhe menaxhuesve të mjeteve që zbatojnë strategjinë investuese dhe alokimin e definuar të mjeteve; përzgjedhjen e kujdestarëve të mjeteve dhe palëve të treta; rekrutimin e personelit ekzekutiv të FKPK-së dhe miratimin e pasqyrave financiare të FKPK-së.

Detyra parësore e Bordit Drejtues është që të sigurojë që mjetet nën menaxhim janë investuar në mënyrë të kujdesshme dhe në pajtim me kërkesat e Ligjit dhe brenda kornizës së parimeve dhe politikës investuese. Bordi Drejtues e pranon se ka përgjegjësi fiduciare kundrejt pjesëmarrësve dhe përfituesve në FKPK, dhe se do të ndjekë vetëm politikat që nuk e cenojnë këtë përgjegjësi.

➤ INFORMIMI I BORDIT DREJTUES

Bordi Menaxherial dhe Njësia për Investime e FKPK-së i informojnë në baza të rregullta (ditore, javore, mujore ose sipas nevojës) anëtarët e Bordit Drejtues për performancën e investimeve të FKPK-së, gjendjen e kontributeve të pranuar dhe mjeteve të paineduara, maturimin e investimeve në obligacionet e Kosovës dhe depozitat bankare, me ndarjen e investimeve sipas klasave dhe strategjive investuese, dhe e gjithë kjo në raport me kufijtë investues - sipas legjislacionit në fuqi.

➤ ZBATIMI I POLITIKËS SË INVESTIMEVE

Bordi Drejtues e ka themeluar një Komision Investimesh (KI), përgjegjësia kryesore e të cilit është të mbështesë Bordin Drejtues me vendimet që kanë të bëjnë me investimin e Mjeteve, duke ofruar mbikëqyrje të funksionit të investimeve. Të gjitha vendimet e politikave, caqet e alokimit dhe limitet e ekspozimit janë përgjegjësi ekskluzive e Bordit Drejtues, pas rekomandimeve të KI-së, ndërsa zbatimi i delegohet Bordit Menaxherial të FKPK-së. KI, bazuar në rekomandimet proaktive të Bordit Menaxherial, në përputhje DPI-në dhe SAA: (a) Vendosi për emërimin dhe largimin e aset-menaxherëve, mbajtësve,

ndërmjetësve, dhe fondeve të përbashkëta; (b) Vendosi për të rritur apo reduktuar pozicionin në një fond të aprovuar të përbashkët apo të tregtueshëm në bursa; (c) Vendosi të blejë ose shesë letra me vlerë individuale të tregtueshme publikisht ose fonde të tregtueshme në bursa.

Bordi Drejtues është i vetëdijshëm se, kur fondet e përbashkëta ose të tregtueshme në bursa përzgjidhen për investim të Mjeteve, menaxherët e fondeve përkatëse kanë diskrecion për të blerë dhe shitur letrat përbërëse me vlerë. Megjithatë, KI-së bazuar në analizën e Bordit Menaxherial, obligohet që vazhdimisht të rishikojë nëse mandati, metodologjia dhe ekspozimet e fondeve përkatëse janë në përputhje me objektivat e FKPK-së.

Bordi Menaxherial i delegohet kompetenca: (a) të ndërmerr ftesë për oferta, dhe caktojë shumat, për afatizime me banka vendore; (b) të hyjë në REPO aranzhime me bankat vendore; dhe (c) vendos për normën dhe shumën ofertuese për obligacionet e Thesarit të Kosovës në ankandet primare, si dhe transaksionet në tregun sekondar. Në të gjitha rastet vendimi i KI-së për investimet duhet të mbështetet nga një arsyetim, analizë dhe hulumtim, si dhe ex-post ndikimin në risk, para se zbatimi të fillojë.

Menaxhimi i parasë për qëllime likuiditeti i delegohet Bordit Menaxherial.

KI dhe/ose Bordi Menaxherial, mund të rekomandojnë iniciimin e ftesës për oferta për fonde të përbashkëta shtesë apo tërheqjen nga një fond i miratuar. KI i shqyrton vendimet dhe performancën e investimeve në baza tremujore dhe i raporton Bordit Drejtues nëse investimet janë në përputhje me politikën dhe me risk të pranueshëm. KI mund të udhëzojë Bordin Menaxherial që bazuar në bindjet e tyre, të përshtatë pozicionin e riskut investues.

➤ RAPORTIMI DHE TRANSPARENCA

FKPK-ja i publikon në uebfaqe të gjitha vendimet e rëndësishme të Bordit Drejtues (që lidhen me investimin e mjeteve), si dhe në baza ditore e publikon në uebfaqen e FKPK-së performancën e investimeve.

Bordi Drejtues dërgon raporte të detajuara (tremujore, vjetore ose sa herë kërkohet) tek institucionet mbikëqyrëse. Më shumë sesa kaq, anëtarët e Bordit Drejtues zhvillojnë takime direkte me anëtarët e komisioneve funksionale të Kuvendit të Kosovës, si për të prezantuar performancën e investimeve ashtu edhe për kërkesën e FKPK-së drejtuar Kuvendit të Kosovës për caktimin e tarifave për financim. E njëjta procedurë vlen edhe për miratimin e raportit vjetor.

FKPK-ja, përmes Menaxhmentit ose Bordit Drejtues, është e prirshme t'i përgjigjet me transparencë të gjitha kërkesave për informacione të medieve relevante, duke shpalosur në detaje performancën dhe të dhënat e tjera rreth investimeve të FKPK-së.

Cikli Vendimmarrjes së Bordit Drejtues

KI takohet (çdo tremujor, e më shpesh sipas nevojës – sipas kushteve në tregjet financiare) dhe i shqyrton e vlerëson të gjitha dokumentet dhe propozimet e ofruara nga Bordi Menaxherial, me qëllim marrjes së vendimeve të reja rreth investimeve. Këtu mund të përfshihen: investimi ose tërheqja e mjeteve, shtimi ose largimi i një fondi investues, ndryshimi në alokimin e investimeve, ndryshimi në strategjinë e investimeve, angazhimin e mbajtësve dhe brokerëve dhe çfarëdo çështje tjetër që kërkon miratimin e Komisionit të Investimeve.

Kryesuesi i Komisionit të Investimeve (KI) i shqyrton analizat, raportet e limiteve dhe rekomandimet e Bordit Menaxherial. Kryesuesi i Investimeve dhe anëtarët e tjerë të KI-së i shqyrtojnë fondet ekzistuese ku FKPK-ja ka investuar, bashkë me gjendjen e tregjeve. Çdo propozim dhe analizë që duhet diskutuar nga KI-ja bashkëngjitet nga propozime të përcaktuara qartë dhe të qarkulluara tek anëtarët e KI-së, të cilët i trajtojnë dhe i diskutojnë ato në mbledhjen e radhës.

Njësia për Investime dhe Njësia për Raportim e Pajtueshmëri ofrojnë analizat e tregjeve financiare, vlerësimin e fondeve investuese, perspektivën globale makro-ekonomike, dhe rekomandimet investuese që pastaj sistemohen dhe dërgohen periodikisht (javore, mujore ose tremujore) tek, Bordi Menaxherial, Komisioni i Investimeve dhe/ose Bordi Drejtues.

Sipas miratimit të Bordit Drejtues, përgatiten raportet tremujore dhe vjetore për të gjitha transaksionet financiare dhe të njëjtat i dërgohen për informim (në baza tremujore dhe vjetore) institucioneve mbikëqyrëse (Bankës Qendrore e Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës).

Bordi Menaxherial merr vendime për investimet në fletobligacionet e Kosovës dhe depozitat me afat në bankat në Kosovë, dhe i shqyrton e vlerëson të gjitha dokumentet dhe propozimet e ofruara nga Departamenti për Investime.

Komisioni i Investimeve njoftohet brenda 24 orësh për vendimet e Bordit Menaxherial.

Bordit Drejtues njoftohet brenda 24 orësh për vendimet e Komisionit të Investimeve.

Menaxhmenti i ekzekuton vendimet e Komisionit të Investimeve dhe Bordit Menaxherial duke i realizuar (përmes Njesisë për Investime dhe Njesisë së Financave) investimet e reja, shitjen ose blerjen e investimeve të caktuara, ose investimin në obligacionet e Qeverisë së Kosovës ose depozitat bankare në Kosovë.

Komisionet e Bordit Drejtues

Katër komisione të përhershme e mbështesin funksionimin dhe vendimarrjen e Bordit.

➤ KOMISIONI I INVESTIMEVE

Përgjegjësia kryesore e të cilit është të mbështesë Bordin Drejtues me vendimet që kanë të bëjnë me investimin e Mjeteve Pensionale, duke ofruar mbikëqyrje të funksionit të investimeve. Anëtarët e KI-së emërohen në përputhje me Statutin e FKPK-së dhe duhet të kenë aftësi, ekspertizë, bagazh profesional dhe përvojë të mjaftueshme për të kryer rolin e tyre në mënyrë efektive. KI do t'i monitorojë dhe do t'i rishikojë vazhdimisht, në bazë të informacionit të disponueshëm: performancën, rreziqet, likuiditetin, diversifikimin dhe përshtatshmërinë e investimeve dhe do t'i raportojë zyrtarisht në mbledhjet e rregullta të Bordit Drejtues. KI do ta shqyrtojë DPI-në të paktën një herë në vit dhe do t'ia propozojë ndryshimet Bordit.

➤ KOMISIONI I AUDITIMIT

Në mesin e funksioneve shqyrton raportet e rregullatorit dhe auditorit, dhe i rekomandon Bordit ndërmarrjen e planit të nevojshëm të veprimit për t'i trajtuar gjetjet dhe çështjet. Komisioni, po ashtu, shqyrton përshtatshmërinë e procedurave të brendshme, dhe në rast nevojë rekomandon ndryshime. Komisioni e shqyrton planin e auditimit për funksionet e auditimit të brendshëm, i shqyrton kriteret për auditorin e jashtëm dhe rekomandon adoptimin e tyre nga Bordi.

Kryesues:

Cyril Demaria

Anëtarë:

Emanuel Bajra
Mimoza Mustafa
Trim Shala
Shpresim Vranovci

Mimoza Mustafa

Trim Shala
Cyril Demaria
Mirlinda Ahmeti (anëtare e jashtme)

➤ KOMISIONI PËR ANKESA

Shqyrton kërkesat, pretendimet dhe ankesat e kontribuuesve që i drejtohen Bordit ose FKPK-së. Komisioni ia paraqet Bordit rekomandimet dhe siguron që të gjitha rasteve t'iu jepet përgjigje brenda afateve dhe në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

➤ KOMISIONI PËR BUXHET

Shqyrton nevojat buxhetore të FKPK-së dhe sipas tyre i jep rekomandime Bordit për nivelin e tarifave që duhen ngarkuar mbi mjetet pensionale. Komisioni gjithashtu i rekomandon Bordit miratimin e buxhetit dhe (kur ka nevojë) ndryshimeve në buxhet. Komisioni po ashtu shqyrton shpenzimet e FKPK-së kundrejt buxhetit.

Kryesues:

Trim Shala

Anëtarë:

Shpresim Vranovci
Emanuel Bajra

Emanuel Bajra

Shpresim Vranovci
Mimoza Mustafa

Menaxhmenti dhe Administrata

Administrata e FKPK-së drejtohet nga Menaxhmenti i lartë, i cili përbëhet nga Drejtori Menaxhues dhe tre drejtorë: Drejtori për Financa dhe TI, Drejtori për Operacione dhe Burime Njerëzore dhe Drejtori për Investime dhe Raportim.

Menaxhmenti synon që të angazhojë në FKPK individë efektivë, profesionalë dhe moralisht të shëndoshë, duke besuar se vetëm këto cilësi do të çojnë në progres më të lartë, ambient të shëndoshë pune e në shërbime më të mira për kontribuuesit; dhe, njëkohësisht, në ruajtjen e integritetit institucional të FKPK-së.

Për t'i arritur objektivat e mësipërme, Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti, duhet të sigurohen që administrata aktuale vazhdon t'i përmirësojë njohuritë dhe përvojën e saj, vazhdon të jetë e motivuar dhe të vë në funksion të gjitha kapacitetet mendore dhe profesionale në shërbim të avancimit të proceseve të brendshme dhe shërbimeve për klientë.

Administrata është e ndarë në njësi funksionale, për të siguruar kështu efektivitet dhe efikasitet në punë. Realizimi i detyrave ditore (në të gjitha fushat operuese) përmirësimi i proceseve administrative, dhënia e ndihmës Bordit Drejtues për analizën e investimeve, si dhe implementimin e vendimeve të Bordit, janë detyrat kryesore të Administratës. Performanca e saj mbikëqyret në vazhdimësi nga Bordi Drejtues, ndërkaq udhëhiqet e zhvillohet në baza ditore nga Menaxhmenti.

Në fund të vitit 2024 pozita të përhershme në FKPK ishin 34, prej të cilave një ishte me angazhim të pjesshëm (më 2023: 29 pozita të përhershme - dy me angazhim të pjesshëm).

Ndërsa këtë vit u dorëhoqën dy anëtarë të stafit, njëri me orar të rregullt dhe tjetri me angazhim në distancë, gjatë vitit u rekrutuan tre zyrtarë në njësinë e investimeve dhe raportimit, një zyrtarë në recepsion dhe tre zyrtarë të sigurimit.

Dy punonjës, që e kishin deklaruar përkatësinë etnike, i përkisnin komuniteteve jo-shumicë. Gratë përbënin 38% të stafit (2023: 41%); 68% e stafit ishin më të vjetër se 35 vjet (2023: 81%), dhe një anëtar i stafit ishte me aftësi të kufizuara të përhershme.

Më lëvizjet e stafit të përhershëm dhe rekrutimin e stafit zëvendësues, mosha mesatare e stafit të FKPK-së këtë vit u ngrit në 44.2 vjeç (2023: 43.7 vjeç).

1 drejtor menaxhues

NJËSIA	SHËRBIKET PËR KLIENTË	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	FINANCAT	INVESTIMET DHE RAPORTIMI
POZITA TË PËRHERSHME	↗ 8	↗ 5	↗ 3	↗ 4
POZITAT	1 menaxher i njësisë 6 këshilltarë pensionalë 1 recepcioniste ↙	1 menaxher i njësisë 2 zhvillues programesh 1 administrator i rrjetit 1 administrator i bazës së të dhënave ↙	1 kontabilist 2 zyrtarë për financa ↙	3 zyrtarë për investime dhe 1 zyrtar për raportim ↙
PËRSHKRIMI	Ofron shërbimet ndaj klientëve. Kujdeset të informojë për llogaritë individuale që nga pagesa e kursimeve pensionale, bilancet e kursimeve dhe po ashtu këshillon pjesëmarrësit mbi pensionet e asistion ata për tërheqje të kursimeve. Mirëmban marrëdhëniet edhe me punëdhënësit me qëllim të përmirësimit të informacionit për t'i barazuar kontributet në llogaritë individuale. Në përgjithësi, ky staf është afër klientit gjatë gjithë ciklit të kursimit e deri në pensionim.	Sigurojnë që e gjithë infrastruktura e teknologjisë së informacionit funksionon gjithë kohën e pa probleme: kujdesen për harduerët, softuerët, licencat, rrjetin e jashtëm e të brendshëm të FKPK-së, sigurinë e të dhënave dhe ruajtjen e të dhënave. Kujdesen që plani i rimëkëmbjes është çdo ditë i vlefshëm dhe e testojnë në baza të rregullta.	Kryejnë të gjitha transaksionet financiare, përfshirë investimin dhe tërheqjen e mjeteve në tregjet financiare; bëjnë llogarimbajtjen dhe kontabilitetin për mjetet pensionale dhe operacionet e FKPK-së. Kalkulojnë çmimin ditor të aksionit (për dyja portofolet) dhe përgatisin pasqyrat financiare, raportet mujore e tremujore dhe raportet e tjera të nevojshme për Bordin e FKPK-së, Rregullatorin dhe Kuvendin, si dhe komunikojnë me menaxhuesit e mjeteve.	Përgatisin analizat mbi: ecurinë e investimeve; riskun dhe luhatshmërinë e portofolios investuese; përputhshmërinë e investimeve me ligjin; mirëmbajtjen e strategjisë investuese të Bordit, përditësimin e dokumentit kryesor të FKPK-së dhe materialeve të tjera sipas kalendarit të raportimeve ose kërkesave nga Menaxhmenti e Bordi Drejtues.

3 drejtorë

BURIMET NJERËZORE DHE ADMINISTRATA	ZYRA LIGJORE	AUDITORI I BRENDSHËM	MARRËDHËNIET ME PUBLIK, TRAJNIMET DHE PËRKTHIMET
↗ 6	↗ 1	↗ 1	↗ 2
1 zyrtar i BNJ 1 shtëpiak 4 zyrtarë të sigurimit	1 zyrtar ligjor	1 auditor i brendshëm	1 menaxher i njësisë 1 zyrtar për marrëdhënie me publik, koordinimin e trajnimeve dhe përkthimeve
↙	↙	↙	↙
Kujdesen për listëprezencën e stafit në punë, respektimin e orarit, përgatitjen e listës së pagave, kompensimeve të tjera dhe mbajnë arkën. Përveç këtyre merren me furnizimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e zyrës; mbajnë arkivin e dokumenteve të institucionit; mbështesin stafin dhe Bordin Drejtues në takime e udhëtime, brenda e jashtë vendit.	Zyra ligjore shqyrton ligjshmërinë e gjithmbarshme të institucionit karshi legjislacionit në fuqi dhe ndihmon në përpilimin e kontratave, marrëveshjeve; jep opinione ligjore dhe e përfaqëson FKPK-në në sistemin gjyqësor. Zyrtarja Ligjore (prej vitit 2023) është edhe Sekretare e Bordit Drejtues.	Siguron Bordin se e gjithë veprimtaria e Menaxhmentit dhe Administratës dhe proceset në FKPK janë në përputhje me procedurat e brendshme, rregullat e BQK-së dhe ligjet në fuqi. Siguron efektivitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të FKPK-së dhe kontrolleve të brendshme duke zhvilluar auditime të rregullta tremujore dhe ofruar rekomandime për zgjidhjen e çështjeve të ngritura. Raportet e Auditorit shqyrtohen nga Komisioni i Auditimit dhe Bordi Drejtues.	E ndërton dhe e mbështet komunikimin e institucionit me medien, publikun dhe institucionet, zhvillimin e intervistave dhe konferencave, përpilimin e raportit vjetor dhe buletinit tremujor; administron uebfaqen dhe (menaxheri i njësisë) e merr rolin e zëdhënësit, kur i delegohet; përgatit raportet e qasjes në dokumentet publike dhe planin vjetor të performancës koordinon dhe ndihmon përkthimin e dokumenteve si dhe e koordinon procesin e trajnimeve, kur ka nevojë.

Mbikëqyrja dhe Auditimi

➤ **FKPK-ja mbikëqyret dhe inspektohet nga BQK-ja, ndërsa auditohet nga auditori i brendshëm dhe i jashtëm.**

FKPK-ja, si një institucion publik i pavarur, është subjekt i mbikëqyrjes nga rregullatorët dhe i auditimit nga auditorë të pavarur dhe profesionalë. Të gjitha këto mbikëqyrje dhe kontrole financiare, nga të cilat nuk kanë rezultuar me gjetje madhore që prej inicimit të aktivitetit të FKPK-së (më 2002), e kanë mirëmbajtur besimin e institucionit tek palët e treta.

Njëkohësisht, Bordi Drejtues beson se këto mbikëqyrje bashkë me performancat e investimeve, kanë forcuar kredibilitetin dhe rritur besimin e publikut të gjerë në vendimmarrjen e Bordit dhe etikën e punës së Menaxhmentit.

Kështu, FKPK-ja çdo tremujor i njofton: BQK-në, Kuvendin dhe Qeverinë për plasmanet e fondeve pensionale, investimet e reja, kthimin nga investimet, por edhe për harmonizimin e mjeteve pensionale. Për informim të publikut ky informacion publikohet gjithashtu edhe në uebfaqen e FKPK-së.

Deri më tani, historikisht, secili auditor i pavarur që ka bërë auditimin e pasqyrave financiare të FKPK-së (operacionale dhe të mjeteve pensionale), të cilët janë përzgjedhur përmes procedurave publike të prokurimit, dhe të miratuara nga Banka Qendrore e Kosovës, nuk kanë dhënë opinion të kualifikuar mbi pasqyrat financiare të FKPK-së.

Auditori i Jashtëm, përmes Letrës së Menaxhmentit, mund të japë edhe rekomandime që e synojnë përmirësimin e funksionit të proceseve të FKPK-së. Përveç raportimit tremujor, mbi përputhshmërinë e investimeve me dispozitat ligjore dhe Rregullat e BQK-së për pensionet, edhe përgjatë 2024-s FKPK-ja çdo muaj i raportoi departamentit të mbikëqyrjes pensionale në BQK. Raportimi përfshin të gjitha aspektet investuese dhe gjendjen e përgjithshme të mjeteve pensionale.

Gjithashtu janë dhënë shpjegime dhe të dhëna sa herë është kërkuar nga BQK-ja. Në rast se investimet e FKPK-së, për shkak të lëvizjeve të tregjeve financiare, rastisin të mos jenë në pajtim me ligjin, atëherë FKPK-ja është e obliguar që menjëherë ta njoftojë BQK-në për këtë, dhe ka afat prej 180 ditësh për ta sanuar gjendjen. As gjatë vitit 2024 nuk kishte ndonjë rast të tillë.

Deri më 31 maj të çdo viti, FKPK-ja e përpilon dhe e dërgon në BQK, Kuvend dhe Qeveri raportin vjetor për vitin paraprak, së bashku me pasqyrat financiare të audituara nga një auditor i pavarur, i cili përzgjidhet vetëm pas pëlqimit të BQK-së. Raporti vjetor, bashkë me pasqyrat financiare, po ashtu publikohet në uebfaqen e FKPK-së.

Në rast të gjetjeve serioze, BQK-ja duhet gjithashtu t'i raportojë Kuvendit, një veprim i cili deri më tani nuk ka qenë i nevojshëm. FKPK-ja e njofton BQK-në edhe për të gjitha vendimet e Bordit që kanë të bëjnë me kontribuuesit, qeverisjen e fondit dhe çështjet e tjera.

FKPK-ja e ka të punësuar një auditor të brendshëm, i cili i raporton së paku katër herë në vit Komisionit për Auditim të Bordit Drejtues të FKPK-së mbi të gjitha aspektet e aktiviteteve të institucionit. Në nëntor të 2024 është angazhuar përmes konkursit publik një specialist me kontratë dhe detyra specifike për auditimin e Teknologjisë Informativë -TI të FKPK-së, i cili do të bëjë auditimin për vitin 2024. Më parë auditimet e TI-së janë realizuar nga një Kompani e kontraktuar përmes prokurimit publik.

Prej 2018-s FKPK-ja vazhdon ta ketë të angazhuar një anëtare të jashtme në Komisionin e Auditimit, sipas kërkesës së Ligjit Nr. 05/L-116, i cili e ndryshon Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë. Ajo anëtare e jashtme është e pavarur nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së.

REKOMANDIME TË NGRITURA NGA AUDITORI I JASHTËM DHE AUDITORI I BRENDSHËM MË 2024 DHE ECURIA

REKOMANDIMET

Nuk është kryer trajnimi i shfrytëzuesve për rimëkëmbje gjatë vitit 2024, përkundër se kërkohet me Plan për Rimëkëmbje nga Fatkeqësitë. Procesi i vlerësimit dhe trajtimit të rrezikut të IT-së, i cili është pjesë e strategjisë së IT-së 2024-2026, ende nuk është përfunduar. Mungesa e një procesi të formalizuar rrit rrezikun e boshllëqeve ose mangësive të mundshme në procesin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit.

Rekomandim: Përmirësim i Menaxhimit ekzistues të Vazhdimësisë së Biznesit me të gjitha detajet përkatëse dhe skenarët e ndryshëm të kërcënimeve, dhe të përfshihen në procesin e ardhshëm të testimit MVB. Rishikim i Analizës mbi ndikimin në biznes në mënyrë që të përcaktohen vlerat kritike të planit për rimëkëmbje nga fatkeqësitë, RPO dhe RTO. Të bëhen analiza të rregullta të vlerësimit të rrezikut të TI-së dhe përshtatje e planit për trajtim të rrezikut për t'i adresuar rreziqet e identifikuara.

Nuk ka akte të brendshme për procesin e menaxhimit të mbrojtjes kundër kodit të dëmshëm (antivirus / antimalware). Dy nga dhjetë dobësitë e gjetura në testin e depërtimit të vitit 2023 - një me rrezik të ulët dhe një me rrezik informativ - janë të pazgjithdhura. Nuk u krye asnjë test depërtimi në vitin 2024.

Rekomandim: Rekomandim: Të trajtohen dobësitë e mbetura nga testi i vitit 2023, dhe në testin e ardhshëm të planifikuar të depërtimit, të ri-testohet infrastruktura e TI-së, dhe nëse dobësitë e mëparshme janë sanuar.

Paragrafi 17.5 i Procedurave të Punës dhe Rregullores së Bordit përcakton: “Takimet e rregullta të Komisionit për ankesa (KAN) do të mbahen të paktën katër (4) herë në vit, dhe KAN do të mbikëqyrë të gjitha ankesat dhe kërkesat e hapura”. Gjatë vitit 2024, janë mbajtur vetëm dy takime pasi Komisioni i Ankesave u mblodh vetëm kur kishte ankesa për t'u shqyrtuar.

Rekomandim: Këshillohet që takimet të mbahen katër herë në vit, siç kërkohet nga rregullorja, ose që rregullorja të ndryshohet në mënyrë që takimet të mbahen vetëm kur ka ankesa për t'u shqyrtuar.

Për dy anëtarë të Bordit Menaxhues janë konfiguruar në sistem me të drejtën për të autorizuar çmimet njësi. Megjithatë, këta anëtarë nuk kanë kryer asnjë veprim të tillë, pavarësisht se e kanë pasur këtë mundësi, individët me të drejta të tepërta në konfigurime që kryejnë veprime jashtë përgjegjësisë të tyre mund të vënë në pikëpyetje efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rekomandim: Rekomandohet që menaxhmenti të heqë qasjen e dy anëtarëve të Bordit Menaxhues për autorizimin e çmimeve të njësisë.

Për tremujorin e raportimit, faqja e internetit e FKPK nuk është përditësuar. Menaxheri i Marrëdhënieve me Publikun (PRM) është i detyruar të marrë konfirmim nga udhëheqësit e njësive të paktën çdo tre muaj për të siguruar vlefshmërinë e përmbajtjes së faqes së internetit që lidhet me njësitë e tyre përkatëse. Informacioni i vjetëruar ose i pasaktë mund të çojë në keqinformim të kontribuuesve dhe të shkaktojë dëmtim të reputacionit.

Rekomandim: Të implementohet një sistem i strukturuar informimesh për të siguruar që udhëheqësit e njësive të ofrojnë konfirmimet e kërkuara çdo tre muaj, siç përcaktohet nga OPP.

ECURIA/KOMENTI

Me angazhimin e Zyrtarit të Sigurisë së Informacionit, vlerësimi i rrezikut të TI-së është planifikuar të bëhet në maj 2025.

Dokumentacioni për Menaxhimin e Vazhdimësisë së Biznesit/Testimin e Vazhdimësisë së Biznesit, duke përfshirë parametrat e zbatueshëm të Objektivit të Pikës së Rimëkëmbjes (RPO) dhe Objektivit të Kohës së Rimëkëmbjes (RTO), pritet të finalizohet përpara ciklit të testimit të dhjetorit 2025.


Procesi për menaxhimin e mbrojtjes kundër kodit dashakeq ndodh, por duhet të formalizohet me politikat e brendshme.

Testi i ardhshëm i depërtimit është planifikuar për tremujorin e katërt të vitit 2025 dhe do të vërtetojë saminin e probleme të mbetura.

Procedurat janë ndryshuar që takimet të mbahen kur ka ankesa për të shqyrtuar.

E drejta për autorizimin e çmimit të njësisë është hequr dy anëtarët e Bordit Menaxhues, duke implementuar rekomandimin e auditorit të brendshëm.

Menaxhmenti pajtohet me gjetjen dhe tashmë e ka zbatuar atë në përputhje me rekomandimin.



↗ Tarifat e Ngarkuara

Tarifat vjetore të ngarkuara mbi mjetet pensionale për vitin 2024 janë ulur në gjithsej në 0.358% të mjeteve (2023: 0.370%).

Megjithatë në vlerë nominale tarifat e 2024-s, prej 10.6 milionë euro, ishin më të larta sesa në vitin paraprak (2023: 9.4 milionë euro).

Përveç të hyrave nga tarifat e ngarkuara, për vitin 2024 kishim edhe të hyra të tjera (jo-tarifore), në vlerën prej rreth 0.4 milionë euro. Kështu FKPK-ja për vitin 2024 pati gjithsej të hyra prej afro 11 milionë euro.

Nga të hyrat e përgjithshme të FKPK-së, rreth 9.2 milionë euro ishin dedikuar për financimin e shpenzimeve investuese (2023: 8.1 milionë euro), ndërsa 1.4 milionë euro ishin dedikuar për financimin e shpenzimeve operationale (2023: 1.3 milionë euro).

Porse tarifat e ngarkuara nuk u shpenzuan në tërësi. Shpenzimet për investimet këtë vit ishin rreth 5.7 milionë euro ndërsa shpenzimet për operatione rreth 1.2 milionë euro. Pra shpenzimet për dyja kategoritë (investime dhe operatione) ishin gjithsej rreth 6.9 milionë euro.

↗ Norma vjetore e Tarifave

Nga tepricat e gjeneruara gjatë vitit, apo 4.1 milionë euro, 3.5 milionë euro i janë kthyer pjesëmarrësve në fondin pensional ku janë trajtuar si të hyra të tjera.

Të hyrat jo-tarifore për vitin 2024 përbëheshin kryesisht nga interesi i afatizimeve me bankat komerciale dhe nga diferenca e shumës nominale të refonduar për mbi-pagesat (apo pagesat e gabuara) të kontributeve dhe vlerës së tyre me rastin e refondimit (përkatësisht 63% dhe 26%).

Financimi

FKPK-ja financohet në mënyrë të ngjashme sikurse të gjitha fondet pensionale me kontribut të definuar, d.m.th. duke ngarkuar tarifa mbi mjetet nën menaxhim (mjetet pensionale).

Si një institucion jo-për-profit, tarifat e ngarkuara nga FKPK-ja ndaj llogarive të kontribuuesve duhet t'i mbulojnë vetëm shpenzimet e saj. Nivelet e tarifave, sipas rekomandimeve të Bordit Drejtues, miratohen nga Kuvendi i Kosovës; duke i siguruar kështu Kuvendit një mënyrë të tërthortë një nivel të kontrollit mbi shpenzimet e FKPK-së.

Sipas ndryshimeve në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-168, FKPK-ja ngarkon tarifën investuese për të mbuluar shpenzimet që lidhen me investimin e mjeteve pensionale dhe tarifën operacionale për mbulimin e shpenzimeve të tjera.

Krahasuar me vitin 2023 FKPK-ja i ka ulur për 2024-n tarifat e ngarkuara (në përqindje), si për aktivitetet operacionale ashtu edhe për ato investuese.

Tarifa operacionale e FKPK-së, sivjet prej 0.048% vjetore, vazhdon të jetë më e ulëta krahasuar me të gjithë operatorët e ngjashëm në rajon por është edhe ndër më të ulëtat globalisht.

Në anën tjetër, mënyra e aplikimit e tarifës investuese (prej 0.310% vjetore) nuk është e krahasueshme me asnjërin prej fondeve të ngjashme pensionale rajonale por as me fondet e ngjashme në botë.

Forma standarde e trajtimit të shpenzimeve investuese nga fondet pensionale është që, krahas taksës operacionale që ngarkohet për operim të shtëpisë menaxhuese, shpenzimet investuese të ngarkohen mbi vetë fondin pensional; pra shpenzimet investuese të trajtohen si shpenzime të fondit e jo siç e kemi në Kosovë, ku këto trajtohen si shpenzime të entitetit që e menaxhon fondin. Ky trajtim po rezulton në shpërputhje midis asaj që FKPK-ja ngarkon si tarifë investuese (gjë që duhet vlerësuar para se viti të fillojë) dhe shpenzimeve që ndodhin në realitet (pasi viti përfundon).

➤ Tabela: Lista e shërbimeve që FKPK-ja i ofron për kontribuuesit

1.	Shërbimin e drejtpërdrejtë në zyrë (shërbim, këshillim, informim) çdo ditë pune prej orës 08:00 deri 16:00.	6.	Njoftimin me postë elektronike dhe fizike për daljen në pension.
2.	Dërgimin e pasqyrave vjetore në shtëpi ose përmes postës elektronike.	7.	Aplikimin për tërheqje kursimesh dhe transfere bankare pa kosto të ngarkuar nga FKPK-ja.
3.	Shtypjen e e pasqyrës në zyrën e FKPK-së (për periudhën deri njëvjeçare)	8.	Mirëmbajtje falas të llogarisë për tërheqje të kursimeve në faza nga bankat komerciale në vend.
4.	Mirëmbajtjen e plotë të llogarisë së kursimeve pensionale.	9.	Kontratë me bankat për kamatë mbi mesatare për kursimet në programin për tërheqje në faza.
5.	Shërbimin elektronik të qasjes online në llogarinë personale pensionale dhe shërbimin për komunikim me mesazhe në Facebook.	10.	Shkarkimin e pasqyrës nga portali eKosova.

Shpenzimet

FKPK-ja, si shtëpi menaxhuese e fondit, ka shpenzime për investimin e mjeteve pensionale dhe për operacionet e saj.

Shpenzimet Investuese

Shpenzimet investuese përfshijnë: tarifat që mbajnë menaxhuesit e fondeve për investimin e mjeteve dhe qasjen në tregjet financiare; tarifat e BQK-së për transferimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve; dhe shpenzimet e tjera për brokerët dhe kujdestarët e mjeteve.

Bordi Drejtues gjatë procesit konkurrues të përzgjedhjes së fondeve investuese i merr për bazë tarifat që menaxherët i ngarkojnë për investimin e mjeteve. Fondet menaxhuese që ofrojnë tarifa më të ulëta kanë përparësi në procesin e përzgjedhjes nga FKPK-ja. Po ashtu duhet pasur parasysh që menaxherët e fondeve ngarkojnë tarifa të ndryshme të menaxhimit në varësi të shumës së investuar si dhe strategjisë së tyre (aktive ose pasive).

Po ashtu kthimi potencial i mundshëm ka ndikim në tarifat menaxhuese. Fondet investuese të tregut të parasë (si shembull) ngarkojnë tarifa menaxhuese më të ulëta sesa fondet në tregjet e aksioneve apo edhe obligacioneve.

Për vitin 2024 shpenzimet për investime përbënin 82.1% të shpenzimeve të FKPK-së (2023: 84.7%). Ato në vlerë nominale ishin €5,660,155 (2023: €5,846,523). Nga e gjithë shuma e shpenzimeve për investime, €5,268,668 ishin për fondet investuese të angazhuara, ndërkaj €391,487 për shpenzime të tregtimit të brokerëve, kujdestarisë dhe shpenzime të tjera investuese.

Niveli i realizimit të shpenzimeve të parashikuara për tarifën investuese për 2024 ishte 61.9% (2023: 71.9%). Si rezultat i moshpenzimit të të hyrave të akumuluar, për vitin 2024 e kishim një një suficit prej €3,536,243 nga aktiviteti investues. Nga kjo shumë, me vendim të Bordit Drejtues, 3.5 milionë euro janë kthyer në fondin pensional.

Kuptohet se për shkak të metodologjisë së caktimit të tarifës së planifikuar vjetore për vitin vijues dhe shpenzimeve të realizuara, që ndikohen shumë nga vendimet taktike investuese, shkalla e realizimit të buxhetit është vështirë e parashikueshme. Për këtë vit kishim ndjeshëm më pak shpenzime investuese për shkak të investimeve në fonde investuese të tregut të parasë së gatshme, sidomos në gjysmën e parë të vitit, të cilat edhe kanë tarifa shumë të ulëta operimi. Gjithashtu këtë vit kishim më shumë fonde ETF të angazhuara, që ndjekin strategji pasive, dhe të cilat kanë tarifa ndjeshëm më të ulëta sesa fondet investuese me menaxhim aktiv të riskut.

Vlen kujtuar se (zakonisht) fondet investuese të menaxhimit aktiv ngarkojnë mesatarisht 0.5% deri 1.0% për menaxhimin e fondeve. Ndërkaq, ETF-të kanë tarifa nga 0.2% e deri në 0.7%.

82.1%
2024

84.7%
2023

Tarifa Investuese

FONDET INVESTUESE	2024	2023
	VLERA NETO E TARIFAVE	VLERA NETO E TARIFAVE
Vanguard – GSIF	€412,961	€25,311
BNY Mellon – RRF	--	€1,032,156
Nordea 1 – GSEF	€743,813	€670,184
Nordea 1 – SRF	€1,324,620	€1,279,152
Amundi – Euro Liquidity	€363,954	€95,363
S&P500 Minvol ETF	--	€44,748
Amundi MSCI Qual	€71,083	--
SP OilGas Expl ETF	€204,707	€196,774
Glob xUS Infr ETF	€346,300	€305,553
iShare US Infr ETF	€222,313	€247,168
BNP Clim. Impact	--	€78,014
Schroder ISF GSG	€75,913	€113,951
iSh. Glb Clean ETF	--	€69,258
Invesco KBW Bank ETF	€26,459	€184,077
Lyxor EUR 10Y Infr ETF	--	€110,437
Vanguard Value ETF	€27,650	€43,100
iSh MSCI Eur Value ETF	€239,873	€214,543
Lyx Stoxx Bank ETF	€17,542	€185,046
iShare Core Dividend ETF	--	€28,314
SPDR EU Energy ETF	€58,312	€55,102
W.Tree Metals ETF	€29,323	€132,005
W.Tree Physical Gold ETF	€8,526	€47,906
SPDR SP Eur Div Aristocrats ETF	€69,942	€53,012
W.Tree Crude Oil ETF	€139,450	€101,430
iShare MSCI Metals Mining ETF	€27,918	€181,046
Vanguard EuZ GovBond ETF	€18,736	€4,488
iShare Resid. M-Factor Real Estate ETF	€132,321	€5,492
Data & Infra. Real Estate ETF	€129,476	€6,608
Amundi MSCI Japan ETF	€78,054	--
SPDR Russell 2000 US SmlCp ETF	€79,615	--
Schroders SISF GSGF	€346,614	--
Invesco S&P500 Eur Hedg ETF	€69,328	--
Global X Data Center & Digital Infr. ETF	€2,116	--
iShares U.S. Digital Infr. & Real Estat	€1,749	--
GJITHSEJ TARIFAT PËR FONDET INVESTUESE	€5,268,668	€5,510,238
Shpenzimet e BQK-së për transfere dhe mirëmbajtje	€79,465	€39,137
Shpenzimet për brokerë, kujdestarë dhe shpenzime të tjera investuese	€312,022	€297,148
GJITHSEJ SHPENZIMET INVESTUESE	€5,660,155	€5,846,523

Shpenzimet Operacionale

Shpenzimet operacionale¹⁾ përfshijnë të gjitha shpenzimet e tjera që nuk janë direkt shpenzime investuese e të cilat përbëhen prej kompensimeve, shtypjes dhe postimit të pasqyrave të llogarive, qirasë së zyrës, dhe shpenzimeve të tjera për operim.

Për vitin 2024 shpenzimet operacionale ishin €1,233,417 (2023: €1,054,703) dhe përbënin 17.9% të totalit të shpenzimeve të FKPK-së (2023: 15.3%). Ato ishin më të larta për 178,714 euro sesa vitin paraprak (+16.9%).

17.9%
2024

Më 2024 buxheti i paraparë operacional u realizua në masën prej 87.1% (2023: 88.4%).

Për vitin 2024 suficiti nga tarifa operacionale ishte €183,422, ndërkohë që €384,053 nga të hyrat e tjera përshtatur për provizionet për humbjet e pritura kreditore në vlerë €6,267, bënë që suficiti i përgjithshëm nga operacionet për vitin të jetë €561,208.

Ngritja e shpenzimeve operacionale këtë vit erdhi kryesisht nga shpenzimet për stafin, me rekrutimet e reja që ndodhën gjatë vitit. Gjithashtu shpenzimet për Bordin Drejtues ishin më të larta, meqë sivjet gjatë gjithë vitit i kishim pesë anëtarë të Bordit në detyrë, dhe dy shtesë që u emëruan nga Kuvendi në dhjetor. Krahësuar me vitin 2023, kur gati pesë muajt të vitit nuk kishim anëtarë të Bordit të emëruar.

Ngritje më të dukshme këtë vit pati edhe shpenzimet për dërgimin e pasqyrave vjetor, me numrin më të madh të pasqyrave dhe njoftimeve që u dërguan tek kontribuuesit, kryesisht për pasqyrat vjetore.

Shifrat për secilën linjë buxhetore prezantohen në tabelën e faqes vijuese, ndërsa shpjegimet e detajuara në pasqyrat e bashkëngjitura financiare.

15.3%
2023

1)

Për më shumë informacione ju lutemi referojuni pasqyrave financiare të audituara, të cilat, sikurse kërkohet me Ligjin për Fondet Pensionale, përgatiten në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Tabela e shpenzimeve Operacionale

	2024		2023	
	në vlerë	në përqindje	në vlerë	në përqindje
Shpenzimet për stafin	€769,812	62.4%	642,021	60.9%
Shpenzimet për Bordin Drejtues	€96,053	7.8%	62,606	5.9%
Zhvlërimi dhe amortizimi	€105,332	8.5%	100,392	9.5%
Dërgimi i pasqyrave dhe korrespondencat	€116,166	9.4%	99,784	9.5%
Shpenzimet për operimin e zyrës	€30,793	2.5%	38,729	3.7%
Mirëmbajtja e softuerëve	€18,015	1.5%	12,243	1.2%
Tarifat e BQK-së për mbikëqyrje	€21,253	1.7%	19,530	1.8%
Shërbimet profesionale/kontraktorët/konsulentët	€14,186	1.2%	25,128	2.4%
Auditimi i jashtëm	€19,000	1.5%	15,700	1.5%
Interesi i qirasë	€11,040	0.9%	13,344	1.3%
Trajnimet, udhëtimet dhe shpenzime të tjera për stafin	€14,788	1.2%	6,548	0.6%
Komunikimi	€6,714	0.5%	5,889	0.5%
Edukimi publik dhe njoftimet	€1,165	0.1%	6,213	0.6%
Tarifat e bankës	€1,977	0.2%	2,141	0.2%
Shpenzimet e tjera	€7,123	0.6%	4,435	0.4%
GJITHSEJ SHPENZIMET OPERACIONALE	€1,233,417	100.0%	1,054,703	100.0%

02

AKTIVITETET

Bordi Drejtues - Menaxhmenti
Menaxhimi i llogarive
Barazimi i kontributeve
Shërbimi për klientë

Aktivitetet e Bordit Drejtues

Vendimi kryesor i vitit 2024 i Bordit Drejtues të FKPK-së ishte miratimi i Deklaratës së Parimeve të Investimeve (DPI), në fuqi prej 1 prillit 2024, e cila deklaratë është përditësuar në tërësi nga versionet e dokumentit paraprak. Në këtë DPI është iniciuar edhe themelimi i Portofolit të Balancuar për moshën 58 deri 62 vjeç, duke përmbyllur një cikël shumë të rëndësishëm të menaxhimit të riskut investues të përshtatur me moshën e kontribuuesve. Portofoli Konservativ, për moshën 63 vjeç e sipër, veçse ishte krijuar në shkurt të vitit 2022.

Në këtë DPI është caktuar që pjesë e përgjegjësisë së drejtpërdrejtë e Bordit Drejtues do të vazhdojnë të jenë rishikimi vjetor i DPI-së, rishikimi vjetor i Strategjisë së Alokimit të Mjeteve dhe shqyrtimi e miratimi i tarifave të fondeve investuese të angazhuara.

Njëkohësisht, Bordi Drejtues në këtë DPI ka vendosur delegimin e disa përgjegjësisë të vendimmarrjes së Bordit Drejtues rreth investimeve tek Komisioni i Investimeve (KI) dhe Bordi Menaxherial.

Ndërsa Komisioni i Investimeve ka qenë një strukturë e kahershme në FKPK (e përbërë nga pesë anëtarë të Bordit Drejtues me përvojë përkatëse), Bordi Menaxherial është strukturë e krijuar më 2024, në përbërje nga Drejtori Menaxhues dhe tre drejtorët: Drejtori për Financa dhe TI, Drejtori për Operacione dhe Drejtori për Investime dhe Raportim.

Bordi në DPI e ka përcaktuar që vendimet rreth investimeve në tregjet globale do të jenë përgjegjësi e Komisionit të Investimeve, ndërsa pjesëmarrja në ankande për fletobligacione të Kosovës dhe investimet në depozitat bankare në Kosovë do të jenë përgjegjësi e Bordit Menaxherial. Në secilin rast Bordi Drejtues informohet menjëherë pas çdo vendimmarrje nga këto dy struktura.

Në nivel të Komisionit të Investimeve, janë marrë 12 vendime këtë vit për investime shtesë në tregjet globale, me një vlerë të përgjithshme prej rreth 1.06 miliardë euro. Ndërsa, po për investimet në tregjet globale, KI i ka marrë edhe 9 vendime për tërheqje investimesh në vlerë të përgjithshme rreth 767 milionë euro.

Pos vendimeve rreth investimeve, Bordi ka shqyrtuar dhe miratuar rishikimin e strategjive dhe planit të operimit për shumicën e fushave të operimit të FKPK-së përgjatë këtij viti. Gjithashtu, Bordi ka shqyrtuar e rishikuar buxhetin vjetor të FKPK-së, bashkë me propozimin e nivelit të tarifave menaxhuese për 2025 për miratim në Kuvendin e Kosovës. Veç tyre, janë diskutuar dhe miratuar raportet e ndryshme të brendshme të FKPK-së (Raporti Vjetor për 2023, raportet tremujore të auditimit të brendshëm dhe Plani i performancës për 2025).

Pjesë e angazhimit të Bordit ishin edhe takimet me Bankën Qendrore të Kosovës dhe komisionet e rregullta të Kuvendit të Kosovës. Anëtarë të Bordit ka marrë pjesë edhe në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare rreth investimeve dhe fondeve pensionale.

Aktivitetet e Menaxhmentit

Me ndryshimet e bëra vendimmarrëse më 2024, aktivitetet e menaxhmentit do të jenë të ndara në nivel të Bordit Menaxherial (për aktivitete të deleguara nga Bordi Drejtues rreth investimeve) dhe detyrat e tjera të zakonshme të operimit ditor të Menaxhmentit. Bordi Menaxherial përbëhet nga Drejtori Menaxhues dhe tre drejtorët, ndërsa Menaxhmenti nga Drejtori Menaxhues, drejtorët dhe menaxherët.

Në nivel të Bordit Menaxherial, Menaxhmenti ka ndihmuar Bordin në rishikimin e DPI-së, përzgjedhjen e aset-menaxherëve, brokerëve, investimeve në ankandet e Qeverisë së Kosovës dhe investimeve në depozitat bankare në Kosovë. Sa i përket investimeve në fletobligacionet e Kosovës, Bordi Menaxherial i ka marrë 13 vendime të tilla, me vlerë rreth 157 milionë euro. Ndërsa për investimet në depozitat bankare 10 vendime me rreth 103 milionë euro.

Ndërsa në nivel të Menaxhmentit ka vazhduar që sigurojë që të gjitha proceset ditore (operacionet) funksionojnë pa ndërprerje. Kjo nënkupton se të dhënat dhe informacionet për kontribuuesit janë të sigurt, se shërbimet ofrohen me standarde të larta profesionale dhe se përfituesit e pensionit i marrin pagesat në kohë. Po ashtu sigurohet se raportet periodike, përfshirë raportin vjetor, përpilohen dhe iu dërgohen institucioneve mbikëqyrëse dhe Rregullatorit në kohë ose sa herë kërkohet; se transferimet e mjeteve pensionale drejt fondeve investuese dhe llogarisë së FKPK-së realizohen saktë; e se komunikimi me menaxhuesit e mjeteve dhe brokerët bëhet në standardet më të larta profesionale dhe përpikëri ligjore.

Mbi të gjitha, duhet garantuar se të gjitha transaksionet financiare janë në përputhje të plotë me rregullat, ligjet dhe standardet (edhe ndërkombëtare) në fuqi.

Menaxhimi i Llogarive

➤ **Më shumë se 585 mijë njoftime për gjendjen e llogarisë u dërguan me postë dhe e-mail.**

Nga gjithsej 874,194 llogari që janë të hapura nga themelimi në FKPK, në ciklin e vitit 2024 janë dërguar 585,498 pasqyra, nga cilat 425,548 me e-mail dhe 159,950 me postë.

Për vitin 2024 janë dërguar 20,599 pasqyra më shumë sesa vitin paraprak, nga të cilat 23,476 pasqyra më pak janë dërguar me e-mail dhe 2,877 pasqyra më shumë me postë. Ndikimin kryesor në rritjen e numrit të pasqyrave të dërguara e kishte hapja e 39,231 llogarive të reja gjatë vitit.

Pasqyrat vjetore nuk dërgohen në rastet kur pjesëmarrësi: 1) nuk ka pasur asnjë transaksion në tri vjetët e fundit (siç është parashikuar me ligj); 2) nuk ka adresë të emailit apo adresë fizike në regjistrat e FKPK-së; si dhe 3) ka bërë tërheqje të përhershme të kursimeve pensionale.

Numri i personave me tërheqje të përhershme që prej themelimit arriti në 80,901.

Për këtë vit i kishim 56,867 punëmarrës dhe 3,771 të vetëpunësuar që i kishin paguar kontributet në vitin paraprak por jo më 2024, pra u pasivizuan. Ndërsa 9,691 punëmarrës dhe 329 të vetëpunësuar u rikthyen më 2024 gjersa nuk kishin kontribuar gjatë vitit 2023, pra u riaktivizuan.

Punëdhënësit mesatarisht kanë deklaruar dhe paguar për 9.42 muaj të 2024-s, me një rënie të lehtë nga viti paraprak (2023: 9.57); dhe të vetëpunësuarit për 3.37 tremujorë të 2024-s, e pandryshuar nga viti paraprak (2023: 3.37).

FKPK-ja gjatë vitit i hapi 39,231 llogari të reja individuale (2023: 41,968), duke e çuar numrin e përgjithshëm të llogarive të hapura prej themelimit në 874,194.

Nga llogaritë e reja të hapura gjatë vitit 39,064 prej tyre ishin për kontribuuesit nismëtarë, d.m.th. që filluan kontribuimin më 2024, kurse pjesa tjetër (879) ishin raste të kontributeve për vitet e mëhershme, për të cilat FKPK-ja e ka marrë qoftë pagesën qoftë informacionin më 2024.

Gjatë vitit ishin 49,080 punëdhënës dhe 26,028 të vetëpunësuar që kishin paguar kontribute për vitin e raportimit (2023: 46,937 dhe 26,878, përkatësisht). Pra ndërsa numri i punëdhënësve është ngritur për 2024 me 4.6% numri i të vetëpunësuarve është ulur me 3.2%.

9.42%
2024

9.57%
2023

Numri mesatar i muajve për të cilët punëdhënësit kanë paguar kontribute





Barazimi i Kontributeve

➤ **Kontributet e pabarazuara ishin sa 0.08% e gjithsej kontributeve të arkëtuara nga themelimi.**

Në llogarinë e FKPK-së, së bashku me kontributet pensionale, mund të ndodh të paguhen edhe gjoba e interesa të ngarkuara nga ATK-ja (ndaj punëdhënësve) për mos-raportim ose mos-pagesë me kohë të kontributeve pensionale. Këto gjoba i takojnë ATK-së, andaj FKPK-ja në baza tremujore, në bashkëpunim me ATK-në, bën identifikimin dhe bartjen (refondimin) e tyre në ATK. Megjithatë, përherë ndodh të ketë kontribute të cilat pranohen, e për të cilat nuk ka informacion se kujt i takojnë apo nëse fare janë kontribute; dhe ato ngelin të pa alokuara.

Edhe në këtë rast në momentin që të gjitha raportet konfirmohen, FKPK-ja e inicion kthimin në ATK të mjeteve që nuk janë kontribute pensionale. Megjithatë, vlen ta rikujtojmë se kontributet e pabarazuara, të cilat janë më të vjetra se gjashtë vjet, sipas legjislacionit në fuqi, kthehen në buxhetin e Kosovës pasi Bordi ka njoftuar Qeverinë e Kosovës se ka shterruar mundësitë e alokimit të këtyre mjeteve tek kontribuuesit përkatës. Ndërsa, pasi të bëhet transferimi i këtyre mjeteve, ligji në fuqi ia ka ruajtur kontribuuesve të drejtën që kurdo që sigurojnë informacione për këto kontribute, të njëjtit do të rimbursohen me vlerën e kontribuimit, duke i shtuar edhe mesataren e kthimit nga investimet e FKPK-së për periudhën nga momenti i pagesës e deri në datën e rimbursimit.

Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së vazhdojnë ta kenë në listë të angazhimeve barazimin e mjeteve për periudhat më të reja se gjashtë vjet, e sidomos për pagesat e vitit të fundit. Kështu edhe për vitin 2024 Bordi Drejtues e kishte vënë objektivin për mjetet e pa alokuara, duke i dhënë këtij procesi vazhdim të vëmendjes në operacionet e përditshme të institucionit.


Duhet cekur këtu se përveç faktit se është përmirësuar dukshëm saktësia e raportimit të kontributeve pensionale (përmes portalit EDI në ATK), po ashtu vërehet se kontribuuesit gjithnjë e më shumë shprehin interesim për gjendjen e kursimeve pensionale, duke reflektuar kështu rritje të vetëdijësimit për rëndësinë e kontribuimit pensional.

Kujtojmë këtu se arsyet kryesore të mosbarazimit të kontributeve janë: (i) gjobat dhe interesat për pagesat e vonuara (ndaj ATK-së) përfshihen në pagesën e kontributeve; (ii) punëdhënësit e dërgojnë listën e pagesave por bëjnë nënpagesa ose mbipagesa të kontributeve; (iii) të dhënat për kontribuuesit në listë (numri personal ose emri) është i pavlefshëm; (iv) punëdhënësit i kryejnë pagesat e kontributeve por nuk e dërgojnë listën e detajuar për kë janë bërë; dhe (v) burimi i pagesës (punëdhënësi) nuk është i identifikuar.

Në fund të vitit 2024 vlera e gjithsej kontributeve të pa alokuara ishte 2,395,695 euro e ulur nga viti paraprak, kur ishte 3,192,323 euro. Ulja e mjeteve të pabarazuara erdhi kryesisht për shkak të kthimit gjatë këtij viti të gjobave dhe interesave të vitit paraprak.

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Kontributet e pa alokuara	€2,395,695	€3,192,323
Kontributet kumulative të njësuara deri në datën e raportimit	€3,181,841,320	€2,701,808,625
Kontributet e pa alokuara si përqindje e kontributeve të njësuara deri në datën e raportimit	€0.075%	€0.118%

Bilanci i fondeve në Llogaritë Individuale



Shërbimi i Klientëve

➤ **FKPK-ja e ka zyrën e vetme për shërbime në Prishtinë por shërbime pensionale ofrohen edhe nga gjashtë zyrat rajonale të ATK-së.**

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës operon prej themelimit me një zyrë të vetme për shërbime, me seli në Prishtinë. Por shërbimet pensionale për: shtypjen e pasqyrës së llogarisë, aplikimin për pension dhe informim për kursimet pensionale ofrohen edhe në gjashtë zyrat rajonale të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Ky bashkëpunim i shkëlqyer institucional mes FKPK-së e ATK-së ka mundësuar shërbime në gjitha qendrat kryesore të vendit pa kosto shtesë për FKPK-në në punësim të stafit, pagesë për qira të zyrave rajonale dhe kosto të tjera operuese.

FKPK-ja i ofron shërbimet e veta në Prishtinë përmes angazhimit të gjashtë zyrtarëve pensionalë, një recepsionisti, një zyrtari të sigurisë dhe menaxherit të njësisë. Në periudha të caktuara angazhohen një deri dy praktikantë, të cilët duke dhënë shërbime për klientët i krijojnë edhe shprehitë e para të punës.

Prej 2022-s, kur është ndryshuar softuerin për menaxhimin e llogarive (IPSA), institucioni e ka përditësuar edhe mënyrën e trajtimit të shërbimeve. Me ofrimin e mundësisë së shkarkimit elektronik të pasqyrës së llogarisë nga portali shtetëror eKosova (përveç se nga eTrusti), tashmë shërbimi më i kërkuari (i marrjes së pasqyrës) është më i lehtë se asnjëherë më parë.

Gjatë vitit 2024 ishin 174,743 kontribuues që morën shërbime nga zyra e FKPK-së dhe zyrat rajonale të ATK-së në gjashtë rajonet e Kosovës. Është tejet pozitive që tashmë shumica e kontribuuesve janë vetëshërbyer, duke marrë pasqyrën e llogarisë së tyre në FKPK përmes portalit eTrusti dhe eKosova. Numri i vetëshërbimeve të kryera sivjet në eTrusti e tejkaloi shifrën 520 mijë.

Ndërsa numri i kontribuuesve që e shkarkuan pasqyrën nga eKosova po ashtu u rrit ndjeshëm dhe e kaloi shifrën e 350 mijë vetëshërbimeve duke qenë dukshëm numri më i larti ndonjëherë. Pra, së bashku, nga eTrusti dhe eKosova kontribuuesit këtë vit i kanë kryer më shumë se 870 mijë vetëshërbime.

Shërbimet më të kërkuara këtë vit janë: Shtypja e pasqyrave të llogarive me 45,540 pasqyra të shtypura. Ky numër përbënte 26% të të gjitha shërbimeve që FKPK-ja i ofroi në zyrën e saj në Prishtinë dhe zyrat rajonale të ATK-së.

Ndërsa vetëm në zyrën e FKPK-së këto ishin shërbimet më të kërkuara sivjet: shtypja e pasqyrave të llogarive (13,061 raste) miratimi i kërkesës për hapje llogarie në eTrusti (27,056 raste), përditësimi i adresave (9,315 raste), miratimi i aplikimeve për pension (7,947 raste), dhe shërbime të tjera për përditësimin e të dhënave (8,328 raste).

Në zyrat rajonale të ATK-së shërbimi më i kërkuar ishte shtypja e pasqyrave me 32,478 raste duke përbërë 51.1% të të gjitha shërbimeve të ofruara nëpër rajone. ndërsa shërbimi i dytë ishte kontrollimi i bilancit të llogarisë (në 31,017 raste).

Përveç të gjitha shërbimeve që janë ofruar në zyrë, FKPK-ja i ka përgatitur dhe iu ka dërguar të gjithë kontribuuesve aktivë pasqyrat vjetore për 2024-shin. Nga gjithsej 793,293 llogari të papensionuara përherë, në ciklin e vitit 2024 janë dërguar 585,858 pasqyra, nga cilat 425,908 me e-mail dhe 159,950 me postë (2023: 449,024 me e-mail dhe 157,073 me postë).

Sipas legjisllacionit në fuqi, jo të gjitha llogarive të hapura iu dërgohen pasqyrat vjetore, duke i larguar llogaritë që nuk ishin aktive në tri vjetët e fundit, ato që pensionohen dhe për ato që nuk ka adresa.

Edhe kontribuuesve që shkojnë në pension të moshës (pra afër moshës 65 vjeçare) iu dërgohen rregullisht letra me postë ose e-mail; ku i informon për kohën e daljes në pension dhe për procedurat e aplikimit për tërheqjen e kursimeve. Edhe pas miratimit të pensionit iu dërgohet përfituesve një letër konfirmuese për shumën e pensioninit, këstet mujore (kur është me këste pagesa) dhe numrin e njësive. Gjithashtu, duke filluar nga viti 2022, të gjithë kontribuuesit që e arrijnë moshën 63 vjeçare, dhe barten në Portofolin Konservativ, njoftohen paraprakisht për këtë lëvizje. Njësoj, prej prillit 2024, edhe të gjithë kontribuuesit që e arrijnë moshën 58 vjeçare, e bartën në Portofolin e Balancuar, njoftohen për këtë lëvizje.

NUMRI I I LLOGARIVE NË eTrusti	2024 339,410
	2023 316,140

NUMRI I VETËSHËRBIMEVE NGA KONTRIBUUESIT në eTrusti dhe në eKosova	2024 870,000
	2023 610,497

numri i shërbimeve të ofruara nga zyra e FKPK-së dhe zyrat e ATK-së për individët dhe punënddhësit	2024 174,743
	2023 235,224

SHTIMI I NUMRIT TË LLOGARIVE NË eTRUSTI

2024
▲ +7%

2023
▲ +5%

#eTrusti është shërbim i bazuar në internet që ofrohet për të gjithë kontribuuesit prej vitit 2010.

Procedurat e regjistrimit realizohen përmes internetit, duke e verifikuar identitetin e kontribuuesit dhe konfirmuar e-mailin.


03

INVESTIMI I MJETEVË PENSIONALE


Deklarata e Parimeve të Investimeve
Shpërndarja e investimeve sipas alokimit strategjik
Shpërndarja gjeografike
Emetuesit kryesorë
Klasat e asetëve dhe valutat
Performanca e investimeve dhe krahasimi

➤ {Siguria e kursimeve pensionale; diversiteti i investimeve; maksimizimi i kthimit për nivelin e ndërmarrë të riskut dhe mirëmbajtja e likuiditetit adekuat janë bërthama e parimeve të matura investuese të FKPK-së}


➤ LËVIZJA E ÇMIMIT TË NJËSISË E PORTOFOLIT STANDARD PREJ THEMELIMIT



➤ LËVIZJA E ÇMIMIT TË NJËSISË E PORTOFOLIT TË BALANCUAR PREJ THEMELIMIT



➤ LËVIZJA E ÇMIMIT TË NJËSISË E PORTOFOLIT KONSERVATIV PREJ THEMELIMIT



Deklarata e Parimeve të Investimeve

Sipas Deklaratës së Parimeve të Investimeve (DPI), e rishikuar dhe në fuqi prej 1 prillit 2024, FKPK-ja do të marrë vendime për investime duke vepruar vetëm në interesin më të mirë të pjesëmarrësve, duke iu përmbajtur prioriteteve të mëposhtme:

- a) Siguria e mjeteve;
 - b) Diversifikimi i investimeve;
 - c) Kthimi maksimal nga investimet në përputhje me sigurinë e Mjeteve; dhe
 - d) Mirëmbajtja e likuiditetit të mjaftueshëm.
- Bordi Drejtues do të përpikët të sigurojë që FKPK-ja të ketë:
- a) Procese efektive dhe efikase të investimeve;
 - b) Nivel të duhurat ekspertizës për analiza dhe veprimtarinë e investimeve në përgjithësi; dhe

- c) Një qasje rigoroze për menaxhimin e shpenzimeve për investime dhe operacione.
- Bordi drejtues do të marrë gjithashtu parasysh se:
- a) FKPK është investitor afatgjatë;
 - b) Ekziston nevoja për të diversifikuar në mënyrë efektive midis klasave të ndryshme të asetëve dhe brenda vetë një klase të caktuar të asetëve;
 - c) Megjithatë performanca investuese matet - dhe tërheqja e kursimeve i paguhet pjesëmarrësve - në euro, kjo nuk duhet ta kufizojë investimin vetëm në Euro asete; dhe
 - d) Pjesëmarrësit duhet ta ruajnë besimin e tyre në institucionin e FKPK-së, për çfarë arsye edhe nevojitet një politikë e kujdesshme investuese.

Gjithashtu, sipas DPI-së, Matësi i inflacionit i caktuar nga Bordi Drejtues është Indeksi vjetor i Çmimeve të Konsumit i Kosovës, i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës. Vënia e inflacionit si objektivi është kyç për mbajtjen e fokusit jo vetëm në mbrojtjen por edhe në rritjen e vlerës reale të asetëve.

➤ Ndarja e portofolave sipas moshës dhe specifikimeve investuese:			
Portofoli	Standard	Balancuar	Konservativ
Grup-mosha	15-57 vjeç	58 – 62 vjeç	63 vjeç e sipër
Objektivi i investimit ¹⁾	Rritje më e lartë e mjeteve, që tejkalon me +3% inflacionin mesatar 10- vjeçar në Kosovë.	Rritje mesatare/e lartë e mjeteve, që tejkalon me +2% inflacionin mesatar 10-vjeçar në Kosovë.	Siguri dhe stabilitet i mjeteve, njësoj ose mbi normën mesatare të obligacioneve kosovare për dy vjetët e fundit.
Qasja e investimeve	Me kahje drejt asetëve afatgjata me pritshmëri për kthim më të lartë, për ofrim të potencialit më të madh për rritje.	Alokim më i balancuar midis asetëve afatgjata dhe atyre me risk të ulët, për tranzicion të pjesëmarrësit nga faza e rritjes në atë parapensionale.	Me kahje drejt asetëve me risk më të ulët dhe kthim të pritshëm të ulët / mesatar, për të ulur efektet e luhatjeve të mëdha e afatshkurtra në tregje.
Toleranca për risk	Moderuar – E lartë	E moderuar	E ulët
Likuiditeti	Nevojë e ulët për likuiditet që mund të plotësohet lehtësisht nga kontributet hyrëse dhe/ ose instrumentet ditore të tregtueshme.	Nevojë e ulët për likuiditet që mund të plotësohet lehtësisht nga kontributet hyrëse, transfertat në portofol ose instrumentet ditore të tregtueshme.	Nevojë e moderuar për likuiditet që do të duhej plotësuar lehtësisht nga transfertat në portofol dhe mbajtja e nivelit të përshtatshëm të parasë së gatshme.

¹⁾ Bordi rezervon të drejtën të vendosë pika referente shtesë për performancën, riskun dhe likuiditetin e investimeve

UNIVERSI I INVESTIMEVE

Mjetet pensionale investohen në lloje të ndryshme të klasave të asetëve, si aksionet, obligacionet, mallrat dhe tregu i parasë. Investimet realizohen direkt ose përmes një sërë strukturash ligjore dhe fondesh investuese (p.sh. fondet e përbashkëta dhe të tregtueshme) që konsiderohen të përshtatshme për FKPK-në si fond pensional dhe investitor afatgjatë. Investimet direkte duhet të bëhen kryesisht në letrat me vlerë që tregtohen publikisht në tregjet e rregulluara. Investimet në: (a) letra me vlerë që nuk tregtohen publikisht në tregjet e rregulluara; dhe (b) obligacione me rangim jo-investues; duhet mbajtur në një nivel të ulët. E njëjta gjë do të vlejë për letrat specifike me vlerë brenda fondeve investuese

Derivatvët, nëse ka, mund të përdoren vetëm për mbrojtje kundër rreziqeve dhe duhet të ndërmerren në mënyrë të kujdesshme dhe me kosto efektive, duke marrë parasysh ekspozimet e mundshme ndaj një pale të vetme ose derivativëve të tjerë. Mjetet duhet të diversifikohen në mënyrë të mjaftueshme dhe efektive në mënyrë që të mos varen ekskluzivisht nga ndonjë klasë e caktuar e asetëve, emetues ose fond investues.

DPI e plotë mund të shkarkohet nga uebfaqja në vegzën në vijim: [Deklarata e Parimeve të Investimeve](#)

Shpërndarja e Investimeve sipas alokimit **Strategjik**

Sipas Deklaratës së Parimeve të Investimeve, në fuqi prej 1 prillit 2024, përcaktohen kufijtë (limitet) e investimeve për të tre portofolat investues. Në rast të tejkalimit të këtyre kufijve në një datë të raportimit, janë tre muaj kohë në dispozicion për ta t’i kthyer investimet brenda kufijve. Në tabelën në vijim janë të dhënat e alokimit strategjik, dhe kufijve përkatës, për datën 31 dhjetor 2024.

Nga gjithsej €3,181,841,320 mjete neto të njësuara më 31 dhjetor 2024: 1) €2,652,013,991 i përkisnin Portofolit të Balancuar (të kontribuuesve të moshës 15 deri 57 vjeç); 2) 376,412,634 euro i përkisnin Portofolit të Balancuar (të kontribuuesve të moshës 58 deri 62 vjeç) dhe 3) 153,414,695 i përkisnin Portofolit Konservativ (të kontribuuesve të moshës 63 vjeçare e sipër).

➤ Investimet e alokimit strategjik sipas peshës dhe kufijve më 31 dhjetor 2024

KLASIFIKIMI	PORTOFOLI STANDARD		PORTOFOLI I BALANCUAR		PORTOFOLI KONSERVATIV	
	PESHA	KUFIRI	PESHA	KUFIRI	PESHA	KUFIRI
RRITJE	54.4%	50-80%	44.4%	40-65%	--	--
Aksione pasive	45.4%	40-60%	30.6%	25-40%	--	--
Aksione aktive	9.0%	10-40%	13.8%	15-25%	--	0-10%
Aksione tematike/ individuale	--	0-15%	--	--	--	--
Asete reale – rritje	--	0-10%	--	--	--	--
Obligacione – rang i ulët	--	0-5%	--	--	--	--
STABILITET	31.7%	31.7%	45.5%	20-60%	89.6%	50-99%
Obligacione – Thesari i Kosovës	7.5%	7.5%	29.2%	20-60%	83.7%	50-99%
Obligacione – rangimi investues	3.3%	3.3%	0.0%	0-25%	--	0-30%
Multi-asete	8.5%	8.5%	4.3%	0-25%	--	0-10%
Asete reale – stabilizuese	8.7%	8.7%	--	--	--	--
Depozita me afat	3.7%	3.7%	12.1%	0-20%	5.9%	0-20%
TAKTIK	1.0%	1.0%	4.6%	0-10%	--	0-10%
Të gjitha klasat e aseteve	1.0%	1.0%	4.6%	0-10%	--	--
LIKUIDITET	13.0%	13.0%	5.4%	0-40%	10.4%	1-30%
Tregje të parasë	12.6%	12.6%	4.5%	0-40%	10.2%	0-29%
Llogari rrjedhëse	0.3%	0.3%	1.0%	0-1%	0.2%	1-10%



Shpërndarja Gjeografike e Investimeve

(TË GJITHË PORTOFOLAT)*

vendi	AMERIKË VERIORE	EVROPË	AZI DHE OQEAN	TË TJERA
shuma	€1,524,536,453	€1,402,311,966	€155,869,645	€100,320,487
përqindja	47.90%	44.06%	4.90%	3.15%

MJETET PENSIONALE INVESTOHEN PËRMES FONDEVE TË HAPURA QË DREJTOHEN NGA MENAXHERËT E KËTYRE FONDEVE NË AKSIONE, INSTRUMENTE BORXHI, PARA TË GATSHME DHE NË INSTRUMENTE TË TJERA FINANCIARE TË KORPORATAVE BOTËRORE DHE TË SHTETEVE SOVRANE. NË FUND TË VITIT 2024 FKPK-JA KISHTE INVESTIME DIREKTE DHE INDIREKTE NË INSTRUMENTE FINANCIARE TË 3,312 EMETUESVE BOTËRORE (2023: 1,993).



	SHTETI	MJETET	PËRQINDJA
1.	SHBA	€1,481,181,249	46.53%
2.	KOSOVË	€601,351,769	18.89%
3.	FRANCË	€236,743,016	7.44%
4.	BRITANI E MADHE	€130,540,184	4.10%
5.	JAPONI	€103,894,862	3.26%
6.	ITALI	€94,453,434	2.97%
7.	GJERMANI	€65,643,763	2.06%
8.	HOLANDË	€44,614,299	1.40%
9.	KANADË	€41,565,471	1.31%
10.	ZVICËR	€39,316,198	1.24%
11.	SPANJË	€38,624,220	1.21%
12.	AUSTRI	€33,453,031	1.05%
13.	SUEDI	€27,840,327	0.87%
14.	LUKSEMBURG	€20,024,303	0.63%
15.	IRLANDË	€19,922,199	0.63%
16.	DANIMARKË	€14,338,915	0.45%
17.	FINLANDË	€13,962,532	0.44%
18.	AUSTRALI	€12,842,239	0.40%
19.	BELGJIKË	€10,828,317	0.34%
20.	TAJVAN	€9,368,089	0.29%
21.	KINË	€8,538,721	0.27%
22.	SINGAPOR	€7,637,727	0.24%
23.	NORVEGJI	€5,363,849	0.17%
24.	PORTUGALI	€4,800,958	0.15%
25.	IZRAEL	€4,758,813	0.15%
26.	HONG KONG	€4,287,307	0.14%
27.	KORE E JUGUT	€2,845,501	0.09%
28.	BRAZIL	€1,986,270	0.06%
29.	MEKSIKË	€1,029,429	0.03%
30.	BERMUDE	€760,304	0.02%
31.	INDONEZI	€725,117	0.02%
32.	URUGUAJ	€684,841	0.02%
33.	TAJLANDË	€541,871	0.02%
34.	AFRIKË E JUGUT	€539,540	0.02%
35.	ZELANDË E RE	€429,398	0.01%
36.	GREQI	€296,901	0.01%
37.	SLLOVAKI	€193,751	0.01%
TË TJERA		€97,109,836	3.06%

Plasmanet Kryesore

➤ Në Thesarin e Republikës së Kosovës ishin të investuara 13.7% e të gjitha mjeteve.

Lista e 25 emetuesve kryesorë, të tre portofolave, prezantohet më poshtë. FKPK-ja ekspozohet ndaj këtyre emetuesve në mënyrë indirekte, përmes fondeve investuese, gjersa plasmanet në Thesarin e Republikës së Kosovës, depozitat me afat (në bankat lokale dhe ato ndërkombëtare) janë direkte.

Në këtë listë nuk përfshihen investimet në fonde të përbashkëta ose tregun e parasë së gatshme. Sikurse dallohet, Thesar i Republikës së Kosovës ishte bindshëm plasmani më i madh në një entitet të vetëm edhe për vitin 2024.

Duhet kujtuar se kufizimet ligjore kërkojnë që FKPK-ja të mos i tejkalojë plasimet siç vijojnë: a) jo më shumë se 30% në Thesarin e Kosovës; b) jo më shumë se 20% e mjeteve në fletobligacione borxhi të një emetuesi të vetëm të vlerësuar me AA ose më lart; c) 10% në fletobligacione të vlerësuara me A ose më lart; d) 5% në fletobligacione të vlerësuara BBB ose më ulët; e) jo më shumë se 5% e mjeteve në një emetues të vetëm për aksione; dhe f) deri 1% në fletobligacione të vlerësuara BB+ ose më ulët.

FKPK-ja nuk i ka tejkaluar asnjë nga këta kufij për investimet në një emetues të vetëm më 31 dhjetor 2024.

➤ Lista e 25 plasmaneve kryesore ku FKPK-ja i kishte investimet më 31 dhjetor 2024

NR.	PLASMANI	VLERA E INVESTIMIT (në milionë)
1.	THESARI I KOSOVËS	€437.1
2.	MICROSOFT	€66.7
3.	APPLE	€57.9
4.	THESARI I ITALISË	€56.7
5.	ALPHABET	€56.5
6.	NLB BANK KOSOVË	€52.6
7.	NVIDIA	€50.1
8.	PCB BANK KOSOVË	€35.2
9.	THESARI I AUSTRISË	€31.8
10.	AMAZON	€30.8
11.	BPCE	€30.2
12.	CREDIT MUTUEL	€28.2
13.	SOCIETE GENERALE	€26.7
14.	CREDIT AGRICOLE	€25.7
15.	META PLATFORMS	€24.6
16.	BPB BANK KOSOVË	€23.4
17.	BNP PARIBAS	€20.5
18.	RBKO BANK KOSOVË	€20.4
19.	VISA	€18.1
20.	BROADCOM	€17.5
21.	TESLA	€17.0
22.	INTESA SANPAOLO	€16.5
23.	ING GROEP	€15.3
24.	JOHNSON & JOHNSON	€14.0
25.	MASTERCARD	€13.9

Klasat e Aseteve

➤ **Bonot përbënin 17.8% e gjithsej mjeteve të investuara.**

Sa i përket valutave, nga 22 fondet e angazhuara në datën e raportimit në Portofolin Standard dhe Balancuar: (a) 13 ishin të denominuara në Euro, në vlerën prej 2,109,342,632 euro, ose sa 65.8% e të gjitha asetëve; (b) 9 ishin të denominuara në dollarë, në vlerën prej 411,136,216 euro, ose sa 12.8% e të gjitha asetëve (2023: (a) 12 ishin të denominuara në EUR, me shumën prej 1,217,778,938 EUR që përfaqësonin 50.2% e gjithsej mjeteve; dhe (b) 9 ishin të denominuara në USD, me shumën prej 367,481,198 EUR, që përfaqësonin 13.5% e gjithsej mjeteve.

➤ Shpërndarja e mjeteve sipas klasave më 31 dhjetor 2024 – Portofoli Standard

KLASA E ASETVE	STRATEGJIA	VLERA E INVESTIMIT
Aksione pasive	Rritje	€1,203,390,138
Tregu i parasë	Likuiditet	€335,392,765
Aksione aktive	Rritje	€238,561,116
Asete reale	Stabilitet	€231,442,650
Multi-asete	Stabilitet	€224,347,147
Obligacione - Thesari i Kosovës	Stabilitet	€198,586,295
Depozita me afat	Stabilitet	€97,555,131
Obligacione	Stabilitet	€88,511,583
Asete reale	Taktike	€26,705,842
Para e gatshme (kesh)	Likuiditet	€8,153,456
GJITHSEJ		€ 2,652,646,123

➤ Shpërndarja e mjeteve sipas klasave më 31 dhjetor 2024 – Portofoli i Balancuar

KLASA E ASETVE	STRATEGJIA	VLERA E INVESTIMIT
Aksione pasive	Rritje	€115,361,969
Obligacione - Thesari i Kosovës	Stabilitet	€109,820,080
Aksione aktive	Rritje	€51,930,328
Depozita e me afat	Stabilitet	€45,414,724
Asete reale	Taktike	€17,371,746
Tregu i parasë	Likuiditet	€16,773,834
Multi-asete	Stabilitet	€16,226,945
Para e gatshme (kesh)	Likuiditet	€3,629,098
GJITHSEJ		€376,528,725

➤ Shpërndarja e mjeteve sipas klasave më 31 dhjetor 2024 – Portofoli Konservativ

KLASA E ASETVE	STRATEGJIA	VLERA E INVESTIMIT
Obligacione - Thesari i Kosovës	Stabilitet	€128,716,670
Tregu i parasë	Likuiditet	€15,670,719
Depozita e me afat	Stabilitet	€9,100,236
Para e gatshme (kesh)	Likuiditet	€376,078
GJITHSEJ		€153,863,703

risku

REJTINGU	CILËSIA E PLASMANIT	INSTRUMENTE TË BORXHIT DHE PARAJA
--	INVESTIMET NË KOSOVË	13.7%
--	JASHTË KOSOVËS	0.2%
AAA	I DORËS SË PARË	0.2%
AA	I LARTË	1.5%
A	I MESËM I EPËRM	0.9%
BBB	I MESËM I ULËT	1.3%
BB	I ULËT	0.0%
B	ME RISK TË MODERUAR	0.0%
C DHE MË I ULËT	ME RISK TË LARTË	0.0%

Performanca Investuese

➤ **Kthimi i përgjithshëm bruto nga investimet për vitin 2024 arriti në €247.2 milionë.**

Kthimi i përgjithshëm bruto për vitin 2024 arriti në €247.2 milionë (2023: €87.7 milionë). Nga kjo vlerë kthimi nga investimet në fondet e hapura investuese ishte €217.8 milionë, duke iu shtuar edhe €6.1 milionë nga dividendat.

Ndërsa nga investimet e tjera në letrat me vlerë të Kosovës dhe depozitat bankare u arritën edhe €19.8 milionë. Gjitha këtyre iu shtua edhe suficiti i kthyer për vitin 2024 (nga moshpenzimi i tarifës për investime dhe operacione) në vlerë prej 3.5 milionë.


➤ Kthimi nga investimet të plasmanëve në fondet e hapura investuese

Fondi	Alokimi në fund të vitit	Kthimi bruto nga investimet
Vanguard Global Stock Index Fund	€631,189,523	€48,683,208
Nordea 1 – Global Stable Equity Fund	€181,176,497	€18,407,327
Nordea 1 –Stable Return Fund X EUR	€240,574,092	€8,439,196
Amundi – Euro Liquidity Fund	€367,837,318	€26,113,123
SPDR® S&P Oil & Gas Exploration & Production ETF	€57,262,281	€1,960,971
Global X U.S. Infra-structure Development ETF	€79,761,835	€16,362,952
iShares U.S. Infrastructure ETF	€78,978,487	€14,809,221
Schroder ISF Global Sustainable Growth	--	€3,450,471
Invesco KBW Bank ETF	--	€2,781,829
Vanguard Value Index Fund ETF	€74,374,114	€12,851,226
iShares Edge MSCI Europe Value Factor UCITS ETF	€91,700,974	€9,893,407
Lyxor EURO STOXX Banks (DR) UCITS ETF	--	€4,156,826
SPDR MSCI Europe Energy UCITS ETF	€30,412,039	€ (1,293,841)
WisdomTree Industrial Metals ETF	--	€ (102,038)
WisdomTree Physical Gold - EUR Daily Hedged ETC	--	€1,243,739
SPDR S&P Euro Dividend Aristocrats UCITS ETF	€22,991,229	€1,069,981
WisdomTree WTI Crude Oil ETF	€26,705,842	€5,080,811
iShares MSCI Global Metals & Mining Producers ETF	--	€ (963,107)
EUR Eurozone Government Bond UCITS ETF	€27,303,649	€391,584
iShares Residential and Multisector Real Estate ETF	€47,754,892	€4,257,710
Pacer Benchmark Data & Infrastructure Real Estate ETF	€26,907,618	€2,069,966
Amundi MSCI Europe Quality Factor ETF	€38,934,838	€ (994,009)
Amundi MSCI Japan EUR Hedged ETF	€42,801,231	€4,879,454
SPDR Russell 2000 US Small Cap UCITS ETF	€30,685,425	€4,765,155
Schroder ISF Global Sustainable Growth (EUR)	€109,314,947	€2,580,831
Invesco S&P 500 EUR Hedged ETF	€298,400,453	€27,469,833
Global X Data Center & Digital Infrastructure ETF	€7,718,155	€(279,726)
iShares US Digital Infrastructure & Real Estate ETF	€7,693,409	€(304,765)
Gjithsej	€2,520,478,848	€217,781,335
Të ardhurat nga dividendët		€6,077,038
Gjithsej të ardhurat nga fondet investuese		€223,858,373

Performanca kundrejt Bençmarkut

Bordi Drejtues i FKPK-së e ka caktuar Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në Kosovë, të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, si cak (bençmark) për ta arritur dhe tejkaluar nga investimi i mjeteve pensionale në Portofolin Standard. Bordi Drejtues beson se tejkalimi i këtij caku është kyç për ta mbajtur vëmendjen tek ruajtja e vlerës reale të kontributeve pensionale në afatgjatë.

Performanca e kënaqshme e FKPK-së në Portofolin Standard për vitin 2024 (prej +8.76%) dhe një ulje e ritmit inflacionist (prej +1.08%) bëri që çmimi i njësisë i Portofolit Standard ta tejkalojë Indeksin e Çmimeve të Konsumit në Kosovë (IÇK). Kështu çmimi i njësisë së FKPK-së u ngrit në kuotën 82.33% nga themelimi, kurse IÇK arriti në 72.00%.



➤ **Krahasimi i çmimit të aksionit të fkpk-së i portofolit standard dhe indeksit të çmimeve të konsumit në kosovë (31.12.2003 deri më 31.12.2024)**

04

KONTRIBUIMI DHE PENSIONIMET

Kontribuuesit nismëtarë

Kontribuimi

Kur dhe si mund të tërhiqen kursimet pensionale?

Pensionimet dhe pagesat

Kontribuuesit Nismëtarë

↗ Kontributet e arkëtuara vjetore u ngritën për 18.2%.

Kontribuuesit nismëtarë

numëronin gjithsej

38,040^{veta} (2023: 40,120) nga të cilët **14.9%**

kontributin e tyre të parë e paguajnë pas moshës **+40** (2023: 13.3%)

një ngritje kjo e lehtë nga viti paraprak.

Mosha mesatare e kontribuuesve nismëtarë

të vitit ishte

26.3^{vjeç} gjersa **67.5%** e tyre ishin **25**^{vjeç}

ose më të rinj (2023: përkatësisht **26.0** vjeç dhe **65.8%**)

Gratë përbëjnë

53.5 të punësuarve dhe **42.2%** të të vetëpunësuarve

(2023: përkatësisht **53.3%** dhe **36.6%**)

Kontribuimi

↗ Janë €3,032.7 mln kontribute të arkëtuara prej themelimit e deri në fund të vitit 2024.

Kontributet e arkëtuara për të punësuarit dhe të vetëpunësuarit këtë vit arritën në €315.8 milionë (2023: €286.2 milionë).

Punëdhënës të rinj sivjet ishin 6,761, një rënie prej -2.9% nga viti paraprak (2023: 6,965). Vitin paraprak ky numër ishte ngritur me 11.9%. Punëdhënës të rinj konsiderohen bizneset, institucionet, e të tjera, të cilat për herë të parë kontribuojnë për punonjësit e tyre.

Në anën tjetër, mesatarja e kontribuuesve aktivë mujorë gjatë vitit 2024 arriti në 347,486, apo +1.0% më e lartë sesa në vitin paraprak (2023: 343,906). Në fund të vitit, bilanci mesatar për të gjitha llogaritë e kursimeve pensionale të kontribuuesve u ngritë theksueshëm për 13.0% në €4,016 (2023: €3,554). Kjo ngritje erdhi më shumë nga kthimi pozitiv i investimeve për vitin, e po ashtu edhe nga rritja e kontributit mesatar e cila u ndihmua nga ngritja e pagës minimale në tetor 2024.

↗ KONTRIBUTET E ARKËTUARA DHE NËN MENAXHIM		
PERIUDHA	KONTRIBUTET E ARKËTUARA (në milionë)	MJETET NETO NËN MENAXHIM (në milionë)
2002-2020	€1,975.8	€1,988.0
2021	€2,189.2	€2,353.2
2022	€2,430.7	€2,411.2
2023	€2,716.9	€2,701.8
2024	€3,032.7	€3,181.3

↗ mjetet neto nën menaxhim - përbërja

2024

Kontribute nën menaxhim



FITIME



2023

Kontribute nën menaxhim



FITIME



Pensionimet dhe **PAGESAT**

➤ **Fitimi i realizuar nga e gjithë vlera e tërhequr për pensione më 2024 ishte 24.0%.**

Gjatë vitit 2024 FKPK-ja ka shpagueur pensione për arsye të arritjes së moshës së pensionimit (65 vjeçare), për arsye të invaliditetit sipas vendimit të Ministrisë kompetente, dhe për arsye të vdekjes së pjesëmarrësit ku mjetet janë trashëguar nga familjarët.

Tërheqjen e mjeteve nga FKPK-ja sipas legjislacionit në fuqi e kanë bërë edhe shtetasit e huaj që nuk ishin të obliguar t'i paguanin kursimet pensionale në FKPK. Fondet që u shpagueu për këto kategori të tërheqjes së kursimeve për vitin 2024 ishin në vlerë €69.7 milionë (2023: €71.6 milionë).

Nga shuma e tërhequr €52.9 milionë ishte pjesa e kontributeve që i kishin paguar vetë kontribuuesit, ndërsa €16.8 milionë ishin fitime të realizuara nga investimi i mjeteve pensionale. Kështu, gjatë vitit mjetet u tërhoqën me rritje mesatare (fitim të realizuar mesatar) prej 31.8% (2023: 32.1%), ndërkohë që tërheqje kishte nga 7,905 llogari (2023: 7,684 llogari). Kështu, numri i llogarive me tërheqje të përhershme nga themelimi shkon në 80,901.

Numri i personave që më 2024 tërhoqën mjeteve pasi arritën moshën e pensionimit ishte 6,044 ose 76.5% e rasteve (2023: 5,876, ose 76.5%). Për arsye invaliditeti ishin 959 persona, ose 12.1% e rasteve (2023: 935 ose 12.2%). Për rastet e vdekjes ishin 867, ose 11.0% (2023: 854 ose 11.0%). Kontribuuesit me status shtetas jo-rezidentë të Kosovës ishin 35 ose 0.4% e rasteve (2023: 27 ose 0.4%).

Prej themelimit e deri në fund të vitit 2024 janë tërhequr gjithsej €700.2 milionë. Nga kjo shumë €556.7 milionë ishin kontribute të paguara nga kontribuuesit dhe €143.5 milionë ishin fitime të realizuara nga investimet. Pra, nga themelimi mjetet e pjesëmarrësve janë tërhequr me një fitim të realizuar mesatar prej 25.8%.

Kur dhe si mund të tërhiqen kursimet pensionale?

Pjesëmarrësi arrin moshën e pensionimit prej 65 vjeç
Një pjesëmarrës që pensionohet me bilanc të kursimeve nën ose të barabartë me pragun prej 3,000 EURO, i merr të gjitha kursimet me një pagesë të vetme. Në anën tjetër, nëse pjesëmarrësi pensionohet me bilanc mbi këtë prag, ai / ajo ka mundësinë të marrë 20% të bilancit menjëherë, ndërsa pjesa e mbetur duhet të merret në faza, përmes pagesave mujore të programit të tërheqjes në faza, derisa sa kursimet të shterojnë. Pagesat mujore caktohen si 1% e bilancit të llogarisë me rastin e riblerjes së njësive nga FKPK, ose 200 EUR, cilado që është më e lartë.

Pjesa që merret në faza, transferohet nga FKPK në bankën komerciale të përzgjedhur nga pjesëmarrësi, dhe më pas banka i bën pagesat mujore te pensionuari. Duke pasur parasysh që mjetet e pjesëmarrësve nuk janë më në kujdesin e FKPK-së, ato nuk bëjnë më pjesë në kontabilitetin e FKPKMP.

Pjesëmarrësi merr pension invalidor

Një pjesëmarrës që është dukë marrë pensioni invalidor, për një numër të caktuar vitesh, siç vendoset nga Ministria përkatëse, mund t'i tërheqë kursimet përmes programit të tërheqjes në faza. Tërheqjet janë të kufizuara në 2,400 EUR për secilin prej viteve që mbulon pensioni invalidor, ose në bilancin e plotë të kursimeve, cilado që është më e ulët. Njësoj si më sipër, këto mjete nuk llogariten më nga FKPKMP, meqë transferohen në bankën komerciale, e cila i bën pagesat mujore prej 200 EUR te pjesëmarrësi derisa fondet të shterojnë.

Pjesëmarrësi nuk është, dhe nuk ka qenë, i detyruar të kontribuojë në fondin pensional

Një shtetas i huaj, i cili kurrë nuk ka pasur nënshtetësi të Kosovës, dhe të cilit kurrë nuk i është lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme statusi i residentit të përhershëm në Kosovë, mund t'i tërheqë të gjitha kursimet pensionale me kusht që (a) personi nuk është shtetas i një vendi me të cilin Republika e Kosovës ka marrëveshje bilaterale ndryshe, dhe (b) Administrata Tatimore të konfirmojë që pjesëmarrësi nuk është, dhe nuk ishte, i detyruar ndonjëherë të kontribuojë.

Pjesëmarrësi vdes para se të mbushë moshën e pensionimit

Trashëgimtari legjitim zgjedh të marrë hisen e tij / saj, të kursimeve të pjesëmarrësit të vdekur, përmes (a) një pagese të vetme, ose (b) transferimit në llogarinë e tij / saj të kursimeve në FKPK. Prioriteti i trashëgimtarëve është si vijon: (1) bashkëshorti/ja, (2) fëmijët dhe (3) të tjerët, siç vendoset nga gjykata ose noteri.

Rregullat për tërheqjen e kursimeve, përfshirë pragjet, përcaktohen nga BQK-ja në Rregulloren e saj për tërheqjen e kursimeve pensionale. Rregullat e tërheqjes në faza janë të kushtëzuara derisa të fillojë ofrimi i anuiteteve në Kosovë.

Tërheqjet



PERIUDHA	KONTRIBUTET E PAGUARA (në milionë)	FITIMI I REALIZUAR (në milionë)	MJETET E TËRHEQURA (në milionë)
2004-2019	€170.8	€32.7	€203.5
2020*	€188.6	€46.4	€235.0
2021*	€49.4	€16.1	€65.5
2022	€40.8	€14.1	€54.9
2023	€54.2	€17.4	€71.6
2024	€52.9	€16.8	€69.7
GJITHSEJ	€556.7	€143.5	€700.2

*E përfshijnë shumën e tërheqjeve të parakohshme të 10% të kursimeve si masë ndaj Covid-19.

Tërheqja e kursimeve pensionale për shtetasit e huaj.

Tërheqjen e kursimeve pensionale nga FKPK-ja (sipas ligjit Nr. 04/L-101 dhe ligjit plotësues 05/L-116) mund ta bëjnë të gjithë shtetasit e huaj që nuk kanë qenë dhe nuk janë të obliguar të paguanin kursime pensionale në FKPK (përfshijtur shtetasit e vendeve me të cilat Kosova ka marrëveshje bilaterale ndryshe). Në rastin e shtetasve të huaj tërheqja bëhet për gjithë bilancin e akumuluar dhe menjëherë.

05

DEMOGRAFIA E KONTRIBUESVE

Kontribuuesit
Shpërndarja gjeografike e kontribuuesve
Mosha e kontribuuesve
Kontribuuesit sipas llojit të ndërmarrjeve
Kontributi mesatar
Niveli i kontribuimit

Kontributi Aktiv

➤ **Ky kapitull i përmbledh të dhënat kryesore demografike për kontribuuesit e FKPK-së më 2024 dhe i bën krahasimet me vitet paraprake.**

Duhet pasur parasysh se ky kapitull i paraqet rezultatet e analizave për të gjitha 874,194 llogaritë e hapura deri më 2024. Në numrin e llogarive gjithsej përfshihen edhe 80,9014 llogaritë me tërheqje të përhershme. Gjatë vitit 2024 u hapën 39,231 llogari të reja.

Numri i kontribuuesve aktivë paraqitet për çdo muaj në pesë vjetët e fundit (në tabelën e faqes vijuese) si dhe mesatarja vjetore për secilin vit. Numri i kontribuuesve për çdo muaj paraqet angazhimin e kontribuuesve secilin muaj dhe nuk është kumulativ. Nga të dhënat mujore vihet re se fundi i tremujorit është gjithnjë me numër më të lartë të kontribuuesve. Kjo ndodh ngase të vetëpunësuarit bëjnë raportime dhe pagesa për tremujor dhe jo çdo muaj (sikur që bëjnë të punësuarit).

Këtë vit mesatarisht ishin 347,486 kontribuues aktivë në muaj (2023: 343,906). Gjatë vitit, me së paku një kontribut në cilësinë e punonjësit shfaqen 426,942 persona ndërkaq në cilësinë e të vetëpunësuarit shfaqen 20,846. Në këto shifra të numëruar dy herë janë 4,577 kontribuues, të cilët shfaqen gjatë vitit edhe si të punësuar edhe si të vetëpunësuar (2023 përkatësisht: 416,182, 21,626 dhe 4,571).

Këtë vit për tetë muajt (janar-gusht) kishte ngritje të kontribuuesve aktivë për secilin muaj krahasuar me të njëjtit muaj të vitit paraprak. Ndërsa për katër muajt e fundit të vitit (shtator-dhjetor) kishte rënie.

Bilanci mesatar i llogarive aktive në fund të vitit 2024 u rrit në €5,974 (2023: €5,223), ose me një ngritje prej +14.4%. Ngritja e bilancit mesatar të llogarive aktive ka ardhur më shumë këtë vit nga kthimi pozitiv nga investimet, e më pak nga ngritja e kontribuimit mujor.

Në anën tjetër, bilanci mesatar i tërhequr me rastin e pensionimit ishte €7,905 (2023: €9,296), ndërsa bilanci i atyre kontribuuesve që kanë kontribuar prej vitit 2002 pandërprerë me pagë mesatare, ishte rreth €13,000 (2023: €11,200).

Gjendja e pakënaqshme e bilancit mesatar të kursimeve pensionale erdhi kryesisht për shkak të nivelit të kontribuimit të pamjaftueshëm për kursime pensionale (prej 10%), që është më i ulëti në Evropë. Bashkë me nivelin e kontribuimit, Kosova është ndikuar edhe nga pagat relativisht të ulëta, sidomos përgjatë periudhës 2002-2015.

FKPK-ja po i thekson, dhe i përsërit, këto fakte duke besuar se është pjesë e përgjegjësisë së saj sociale për të ndikuar që secili shtetas i Kosovës do të duhej të ketë kursyer mjaftueshëm për pensionin e vet, që do t'i mundësojë një jetë më të sigurt pas pensionimit, në kuptimin financiar.

Sipas treguesve aktualë, me këtë trend të kontribuimit, nuk mund të planifikohet që shumica e të punësuarve të sotëm do të mund të kenë pension të mjaftueshëm nga kursimet pensionale në FKPK, dhe kështu rrezikojnë të vazhdojnë të jenë barrë për shtetin dhe/ose shoqërinë.

NUMRI I KONTRIBUUESVE AKTIVË PËR ÇDO MUAJ NË PESË VJETËT E FUNDIT



	2024	2023	2022	2021	2020
JANAR	337,840	328,834	315,905	291,571	278,915
SHKURT	339,894	330,471	317,639	296,573	281,309
MARS	360,646	355,133	344,748	330,988	333,976
PRILL	345,894	337,361	328,814	303,679	321,387
MAJ	345,295	341,050	330,856	306,769	258,718
QERSHOR	368,113	364,610	353,434	328,749	304,820
KORRIK	350,118	346,098	332,154	312,725	287,817
GUSHT	345,964	344,534	331,105	311,886	289,344
SHTATOR	363,107	363,584	351,045	332,912	313,612
TETOR	339,603	340,433	330,169	324,599	298,224
NENTOR	337,768	336,129	321,635	320,014	298,792
DHJETOR	337,586	338,640	321,150	328,195	319,225
MESATARJA	347,486	343,906	331,555	315,722	298,845

Shpërndarja Gjeografike

Meqë një pjesë e madhe e kontribuuesve aktivë (18% e tyre) paguhen nga Ministria e Administratës Publike, zyra e së cilës është e regjistruar në Prishtinë, dhe meqë nuk kemi informacione të tjera përveç atyre ku punëdhënësi është i regjistruar, nuk e kemi të mundur të bëjmë analiza mbi atë se ku kanë punuar saktësisht kontribuuesit gjatë vitit.

Kjo është arsyeja përse FKPK-ja i prezanton vetëm analizat e bazuara sipas adresave të kontribuuesve nëpër komuna, që FKPK-ja i ka në regjistrat e saj, dhe nuk e ka të mundur t'i përdorë të dhënat e tjera të zonës gjeografike. Për vitin 2024 ishin 34 komuna me shtim, ndërkaq në pesë komuna kishte rënie, të numrit të kontribuuesve aktivë.

Rënie të numrit të kontribuuesve këtë vit kishte në Gjakovë, Deçan, Partesh, Hani i Elezit dhe Leposaviq. Më e theksuar këtë vit del të jetë ngecja e shtimit të numrit të kontribuuesve aktivë në Prishtinë, ku ngritja është për vetëm +0.74% nga viti paraprak. Në të gjitha 10 komunat më të mëdha, përjashtuar Gjakovën, kishte ngritje, porse me ritëm të ngadalësuar krahasuar me vitin 2023.



TABELA E KONTRIBUESVE SIPAS KOMUNAVE

➤ NDRYSHIMI ME 2023

NR.	KOMUNA	NR. KONTRIBUESVE		NË NUMËR	NË %
1.	PRISHTINË	80,209	17.73%	593	0.74%
2.	PRIZREN	36,612	8.09%	577	1.60%
3.	FERIZAJ	29,604	6.54%	814	2.83%
4.	PEJË	25,009	5.53%	366	1.49%
5.	GJILAN	24,612	5.44%	863	3.63%
6.	GJAKOVË	23,120	5.11%	-357	-1.52%
7.	PODUJEVË	22,155	4.90%	477	2.20%
8.	VUSHTRRI	18,968	4.19%	711	3.89%
9.	MITROVICË E JUGUT	18,839	4.16%	329	1.78%
10.	LIPJAN	16,721	3.70%	643	4.00%
11.	DRENAS	14,957	3.31%	95	0.64%
12.	FUSHË KOSOVË	13,287	2.94%	495	3.87%
13.	SUHAREKË	12,255	2.71%	264	2.20%
14.	SKËNDERAJ	11,958	2.64%	215	1.83%
15.	RAHOVEC	9,755	2.16%	206	2.16%
16.	ISTOG	9,361	2.07%	211	2.31%
17.	MALISHEVË	9,298	2.06%	151	1.65%
18.	VITI	8,894	1.97%	190	2.18%
19.	KAÇANIK	7,768	1.72%	465	6.37%
20.	KLINË	7,641	1.69%	201	2.70%
21.	KAMENICË	7,436	1.64%	186	2.57%
22.	OBILIQ	7,222	1.60%	282	4.06%
23.	SHTIME	6,426	1.42%	186	2.98%
24.	DEÇAN	6,322	1.40%	-53	-0.83%
25.	DRAGASH	4,751	1.05%	50	1.06%
26.	GRAÇANICË	2,325	0.51%	142	6.50%
27.	SHTËRPCË	1,973	0.44%	87	4.61%
28.	PARTESH	1,571	0.35%	-35	-2.18%
29.	HANI I ELEZIT	1,280	0.28%	-26	-1.99%
30.	NOVOBËRDË	922	0.20%	130	16.41%
31.	LEPOSAVIQ	878	0.19%	-45	-4.88%
32.	MAMUSHË	871	0.19%	53	6.48%
33.	ZUBIN POTOK	804	0.18%	60	8.06%
34.	JUNIK	680	0.15%	30	4.62%
35.	MITROVICË E VERIUT	669	0.15%	178	36.25%
36.	ZVEÇAN	612	0.14%	69	12.71%
37.	KLLOKOT	431	0.10%	14	3.36%
38.	RANILLUG	336	0.07%	13	4.02%
	TË TJERË*	5,834	1.29%	1,152	24.60%

Mosha Kontribuuesve

Mosha mesatare e të gjithë kontribuuesve në vitin 2024 u ngrit lehtë në 41.7 vjeç nga 41.4 sa ishte fundvitin paraprak. Ndërsa mediana e të gjithë kontribuuesve nuk ndryshoi – ngeli 39 vjeç edhe për vitin 2024.

Mosha mesatare sipas gjinisë njohu lëvizje të lehtë. Për burrat arriti në 43.5 vjeç (nga 43.4 vjeç) ndërsa mediana nuk ndryshoi, ngeli 41.0 vjeç. Te gratë mesatarja u ngrit jo pak 38.6 vjeç (nga 38.0 vjeç), ndërsa mediana ngeli e njëjtë, 36.0 vjeç.

MESATARJA BURRA:

43.4




MEDIANA BURRA:

41.0

MESATARJA GRA:

38.6



MEDIANA GRA:

36.0

Sa i përket kontribuuesve sipas grupmoshave, është mjaft pozitive që në grupmoshën 15-24 vjeç e kishim ngritjen më të lartë të kontribuuesve këtë vit (nga 18.9% në 19.3%).

Në anën tjetër nuk është e kënaqshme që kontribuuesit e grupmoshave 25-34 vjeç dhe 25-44 vjeç kishin numër të reduktuar ose të pandryshuar, përkatësisht.

Këtë vit ngritje të kontribuuesve kishte në grupmoshën 45-54 vjeç dhe 55-64 vjeç, ndërsa ulje të lehtë kishte tek kontribuuesit 65+ vjeç.



GRUPMOSHA	2024	2023
15-24	19.3%	18.9%
25-34	26.6%	27.3%
35-44	22.9%	22.9%
45-54	18.1%	17.9%
55-64	12.3%	12.1%
65+	0.8%	0.9%

Kontribuuesit sipas Ndërmarrjeve

Lloji i ndërmarrjeve përcaktohet sipas regjistrimit të tyre në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare ose në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Duhet theksuar se ndërmarrjet publike dhe shoqërore (të tilla si kompanitë rajonale të ujësjellësit ose mbeturinave, Posta e Kosovës, ngrohtoret e qytetit etj.) shumica e tyre janë të regjistruara si shoqëri aksionare.

Prandaj paraqiten së bashku me ndërmarrjet e tjera publike, në kuadër të grupit të shoqërive aksionare. Gjithashtu, numri i kontribuuesve sipas ndërmarrjeve nuk përputhet me numrin e kontribuuesve aktivë për vitin, për shkak se tek shifrat sipas ndërmarrjeve një kontribuues paraqitet më shumë sesa njëherë - nëse gjatë vitit ka kontribuar përmes dy a më shumë llojesh të ndërmarrjeve.

Për vitin 2024 rezulton se kishte ngritje të kontribuuesve nga organizatat buxhetore, SHPK-të, shoqëritë aksionare dhe OJQ-të. Ndërsa kishte reduktim tek bizneset individuale, ortakëritë dhe tek të tjerat.

Pozitive për këtë vit është ngritja në numër e kontribuuesve tek SHPK-të, për 12,707 raste (5.4%) më shumë sesa vitin paraprak. Tek organizatat buxhetore ishin 4,268 kontribuues (4.8%) më shumë. Shoqëritë aksionare i shtuan 1,108 kontribuues (3.9%), ndërsa OJQ-të 50 (0.2%) më shumë.

Nga tjetra anë, bizneset individuale raportuan 4,906 kontribuues (7.2%) më pak, ndryshimi më i lartë nëpër sektorë. Ulje të kontribuuesve kishte edhe tek të vetëpunësuarit, me 774 (2.9%) dhe Ortakëritë me 99 raste –(3.0%) më pak.

LLOJI I NDËRMARRJES	2024	2023
Organizata Buxhetore	94,063	89,795
SH.P.K.	249,574	236,867
Biznese Individuale	62,814	67,720
Të vetëpunësuar	25,423	26,197
Shoqëri Aksionare	29,571	20,708
OJQ	20,758	20,708
Ortakëri	3,100	3,199
Të tjera	10,224	10,866





Kontributi Mesatar

Në tabelat në vijim prezantohen të dhënat për kontributin mesatar mujor për tri vjetët e fundit e deri në fund të 2024-s. Të dhënat janë paraqitur sipas llojit të kontribuimit, sipas grupmoshës dhe gjinisë së kontribuuesve.

Lajm mjaft pozitiv për këtë vit është që kontributi mesatar mujor është ngritur dukshëm, me 12.0% për punëmarrësit dhe 13.8% për të vetëpunësuarit. Por kjo ngritje e kontributit mesatar mujor mund të jetë ndikuar në një masë edhe nga ngritja e pagës minimale (në 350 euro në muaj prej tetorit 2024).

Tek punëmarrësit ngritja në kontributin mesatar mujor ishte e dukshme tek të gjitha grupmoshat dhe tek të dyja gjinitë. Ngritja më e madhe e kontributit mesatar ishte tek punëmarrësit e grupmoshës 65+ vjeçare. Por, sakaq, kjo grupmoshë ishte edhe e vetmja me ulje të kontributit mesatar të të vetëpunësuarve; e kuptueshme kjo kur dihet se kontribuimi në këtë moshë është vullnetar.

Tek punëmarrësit, për grupmoshat 25-34 vjeç, 35-44 vjeç dhe 45-54 vjeç, ngritja në kontributum ishte shumë afërt, përkatësisht: +11.9%, 11.7% dhe 11.8% nga viti paraprak. Ndërsa grupmosha 15-24 vjeç kishte ngritje për 10.6% dhe grupmosha 55-64 vjeç me 7.8%.

Tek kontributi sipas gjinisë, rezultoi se punëmarrëset këtë vit e kishin ngritjen më të lartë të kontributit mesatar mujor, prej 18.3%, kundrejt 11.8% sa u rrit kontributi mesatar i punëmarrësve.

Por përsëri, burrat kanë kontribute mesatare dukshëm më të larta, prej 58.9 euro, kundrejt graveve që u ngritën në 33.2 euro. Ky është tregues që lë hapësirë për të supozuar se në Kosovë gratë mund të paguhen dukshëm më pak sesa burrat.

KONTRIBUIMI MESATAR MUJOR		2024	2023
VITI	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR	
2022	€53.07	€35.08	
2023	€59.70	€36.08	
2024	€66.88	€41.07	

Kontribuimi mesatar mujo sipas Grupmoshave

↩ KONTRIBUIMI MESATAR MUJOR SIPAS GRUPMOSHAVE

	2024		2023		2022	
MOSHA	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
15-24	€46.27	€27.05	€41.82	€22.76	€35.50	€23.27
25-34	€66.76	€34.58	€59.66	€29.17	€50.75	€26.78
35-44	€75.09	€40.82	€67.20	€36.42	€60.08	€35.37
45-54	€74.79	€43.45	€66.87	€38.39	€60.10	€37.41
55-64	€73.89	€44.95	€68.51	€40.97	€61.14	€40.04
65+	€82.18	€46.93	€68.12	€51.48	€70.56	€44.08

↩ KONTRIBUIMI MESATAR MUJOR SIPAS GJINISË

	GRA		BURRA	
VITI	PUNËMARRËSE	TË VETËPUNËSUARA	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
2022	€46.87	€28.20	€57.17	€36.84
2023	€52.73	€28.10	€64.55	€38.23
2024	€58.95	€33.25	€72.44	€43.27

Niveli i Kontribuimit

Lartësia e kontributit minimal mujor, për një të punësuar me orar të plotë, vazhdon të jetë sa 10% e pagës minimale.

Deri në shtator 2024 kjo ka nënkuptuar kontribut minimal mujor prej €13 për personat deri në 35 vjeç dhe €17 për personat mbi 35 vjeç. Për të vetëpunësuar, këto shifra ishin €39 dhe €51 përkatësisht, për shkak se ato paguhen në baza tremujore.

Por, me hyrjen në fuqi në tetor 2024 të pagës minimale mujore prej €350, pavarësisht moshës, kontributi minimal duhet të jetë €35 në muaj për të punësuarit, apo €105 në tremujor për të vetëpunësuarit.

Sipas të dhënave të tremujorit të fundit, kur paga minimale u rrit në €350 në muaj, rezulton se punëmarrësit në masë të madhe (prej 80.3%) kanë kontribuar më shumë sesa paga minimale, 12.5% kontribuan sa paga minimale, ndërsaq 7.2% më pak sesa paga minimale.

Krejt ndryshe ishte situata tek të vetëpunësuarit, ku pjesa më e madhe e tyre paguan kontribute vetëm sa minimumi i kërkuar (73.8%), më pak se çereku paguan më shumë sesa minimumi (23.9%), ndërsaq 2.3% paguan kontribute nën minimumin ligjor.

↙ NIVELET E KONTRIBUIMIT TË PUNËMARRËSVE

			PAGESA
	NËN MINIMUM	SA MINIMUMI	MBI MINIMUM
Niveli i pagesës	7.2%	12.5%	80.3%

↙ NIVELET E KONTRIBUIMIT TË TË VETËPUNËSUARVE

			PAGESA
	NËN MINIMUM	SA MINIMUMI	MBI MINIMUM
Niveli i pagesës	2.3%	73.8%	23.9%



06

LEGJISLACIONI

Korniza ligjore
Ndryshimet e propozuara

Korniza Ligjore dhe **Ndryshimet**

Organizimi, funksionimi dhe vendimmarrja e FKPK-së bazohet në Ligjin Nr. 04/L-101, së bashku me plotësimet dhe ndryshimet me: Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin Nr. 04/L-168 dhe me Ligjin Nr. 05/L116, si dhe qeveriset nga Bordi Drejtues.

Organizimi ligjor i FKPK-së saktësohet tutje edhe me legjislacionin sekondar: përmes rregulloreve për pensione të BQK-së, dhe udhëzimeve e njoftimeve shpjeguese të ATK-së për mënyrën e deklarimit, kontribimit, korrigjimit dhe tatimit të kontributeve pensionale.

Në faqen vijuese kemi prezantuar propozimet tona për plotësime /ndryshime ligjore për çështjet më të rëndësishme aktuale në fushën e kursimeve të obligueshme pensionale.

Propozime për **Plotësime/Ndryshime** Ligjore

1. KUFIZIMET PËR INVESTIMET NË LETRAT ME VLERË TË QEVERISË SË KOSOVËS

Kufizimi aktual ligjor që deri 30% e mjeteve mund të investohen në fletobligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës mund të rritet në 50%, për të mundësuar më shumë investime në këtë instrument. Gjithashtu mund të rishikohet edhe kufizimi tjetër rregullues që përcakton se FKPK-ja mund të ofrojë maksimumi sa 50% e shumës së një ankandi të fletobligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2. PASQYRAT VJETORE TË LLOGARIVE

Legjislacioni kërkon që pjesëmarrësve t'iu dërgohet pasqyra vjetore me shkrim. Përderisa dërgesat me email janë mjaft të sigurta, ato me postë, edhe për shkak të mungesës së adresave të sakta, jo rrallë nuk e arrijnë personin e duhur. Falë edhe portalit eTrusti, dhe qasjes në të përmes eKosova, duhet të hiqet apo ndryshohet kjo kërkesë ligjore, meqë qasja në pasqyrë është e mundur në çdo kohë.

3. INVESTIMET NË "TREGJE PRIVATE"

Është e nevojshme që FKPK-ja, sikurse shumë fonde pensionale në botën e zhvilluar, të lejohet të investojë përmes aset-menaxherëve në investime alternative të tilla si "Private Market Funds" (fonde private të aksioneve). Investimet alternative mbulojnë klasa të ndryshme të mjeteve, siç janë kapitali privat, infrastruktura ose pasuritë e paluajtshme. Kjo do t'i shërbente diversifikimit, e ku alokimi do kufizohej mes 5% deri 10% të mjeteve.

4. HARMONIZIMI I SHPAGIMIT TË KURSIMEVE PENSIONALE DHE JETËGJATËSISË SË PRITUR

Për shkak se legjislacioni aktual nuk lejon që anuiteti nga shtylla e dytë të jetë më i ulët se pensioni minimal i dhënë nga shtylla e parë, shuma mujore që shpaguhet nga FKPK-ja harxhohet shumë shpejt. Po ashtu, meqenëse shtylla e dytë do të duhej ta financonte pjesën kryesore të pensionit, shuma e kursyer duhet të lidhet edhe me jetëgjatësinë e pritur. Për shkak se FKPK-ja akoma nuk e ka arritur maturinë e plotë (40 vjet), do të duhej të ndërlihej me përfitimet e shtyllës së parë, në mënyrë që të kemi pension të unifikuar. Psh. Të përpjestohet shuma e kursyer me vitet e jetëgjatësisë së pritur, atij bilanci t'i shtohet pensioni bazik dhe përfituesi të ketë një vlerë pensionimi të njëjtë gjatë tërë jetëgjatësisë së tij. Në fillim kjo do të financohej në tërësi nga kursimet individuale në FKPK, ndërsa më vonë (kur këto mjete harxhohen), ky financim do të kalonte në buxhetin e shtetit. Pjesa që do të kursehej në fillim, do të shërbente që të financohej ky pension i kombinuar deri në fund të jetës së pensionistit. Pra, më këtë do të rrumbullakësohej edhe qëllimi i skemës pensionale, ku secili pensionist do ta merrte pensionin për tërë jetëgjatësinë e tij, në varësi të kontributit të tij. Përderisa tani marrin 20% të kursimeve si pagesë të mënjëhershme dhe së paku €200 euro në muaj si dhe pensionin bazë, ky bilanc shteron vetëm për 4-5 vjetët e para. Më pas vlera e pensionit mujor bie drastikisht, duke u mbështetur vetëm në pensionin që financonet nga Shtylla I.

5. TËRHEQJA E KURSIMEVE PENSIONALE PËR RASTE E PAAFTËSISË PËR PUNË

Kjo mundësi ligjore duhet të modifikohet, meqë tërheqja e mjeteve aktualisht po mundësohet edhe për personat të cilët ose janë ri-aftësuar ose edhe punojnë. Duhet të ketë një përcaktim më të qartë të fillimit dhe mbarimit të kësaj të drejte.

6. LLOGARITË JOAKTIVE

Duhet paraparë me ligj, se çfarë duhet bërë me llogaritë e kursimeve pasi që ato kanë pushuar së kontribuuari për një kohë të gjatë (p.sh. kur kontribuuesi arrin mbi 100 vjet dhe ende nuk i ka tërhequr mjetet vetë e as ndonjë trashëgimtar).





E PËRGATITI

NJËSIA PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIK

E RISHIKOI

MENAXHMENTI I FKPK-SË
AUDITORI I BRENDSHËM

E MIRATOI BOTIMIN

BORDI DREJTUES I FKPK-SË

ADRESA

Rr. "Agim Ramadani" #182-184
10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL DHE UEB

info@trusti.org
www.trusti.org



Fondi i Kursimeve
Pensionale i Kosovës



Fondi i Kursimeve
Pensionale i Kosovës

Trusti
info@trusti.org
www.trusti.org